



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



**swei** 

**HULUMTIMI I TREGUT NË FUSHËN E  
MBLEDHJES DHE PËRPUNIMIT  
TË FRUTAVE TË MALIT DHE  
BIMËVE MJEKËSORE**

[www.fb.com/swei.alks](http://www.fb.com/swei.alks)

**Raport i hulumtimit të tregut në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të Frutave të Malit dhe Bimëve Mjekësore**

Konsulentët e angazhuar në hulumtim: Linda Abazi – Morina dhe Bukurosh Onuzi

Janar 2019



Financuar nga Bashkimi Evropian

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit “Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik - SWEI” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i cili implementohet nga APPK-Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë dhe ISI - Instituti për Studime Ndërkombëtare në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian

# PËRMBAJTJA

<b>Përmbajtja</b> .....	<b>3</b>
<b>1. Lista e Shkurtesave</b> .....	<b>5</b>
<b>2. Përmbledhja ekzekutive</b> .....	<b>6</b>
<b>3. Hyrje</b> .....	<b>8</b>
<b>4. Shqipëria</b> .....	<b>10</b>
4.1 Potencialet e Bimëve Mjekësore .....	10
4.2 Rajoni Lezhës .....	11
4.3 Rajoni Kukësit .....	12
4.4 Të gjeturat nga tereni: Sfidat dhe nevojat në zhvillimin e veprimtarisë .....	14
4.4.1. Identifikimi i ndërmarrjeve, që merren me Frutat e Malit dhe Bimët Mjekësore ..	15
4.4.2 Shpopullimi, cilësia e produkteve .....	16
4.4.3 Mungesa e trajnimeve .....	17
4.4.5 Konkurrencë e pabarabartë në treg .....	17
4.5 Sfidat tjera të identifikuar .....	17
4.6 Nevojat e punëdhënësve për të zvogëluar zbrazësitë në mes të kërkesës dhe ofertës. ....	18
4.7 Grumbullimi, përpunimi dhe tregtimi frutave të malit. ....	19
4.8 Grumbulluesit lokal dhe tregtarët ambulant që tregtojnë gështenjën.....	19
4.9 Grumbulluesit dhe përpunuesit e gështenjës.....	20
4.9.1 Produktet e patregtuara .....	20
4.9.2. Pengesat dhe vështirësitë sipas hallkave të zinxhirit të vlerës .....	21
4.9.3 Pengesat dhe vështirësitë kryesore në aspektet e përpunimit .....	22
4.9.4 Ecuria e bizneseve të bimëve mjekësore gjatë viteve të fundit.....	22
<b>5. Kosova</b> .....	<b>23</b>
5.1 Profilet e komunave .....	24
5.1.1 Komuna e Prizrenit .....	24
5.1.2 Komuna e Dragashit .....	24
5.1.3 Komuna e Mamushës.....	24
5.1.4 Komuna e Suharekës .....	25
5.1.5 Komuna e Rahovecit .....	25
5.1.6 Komuna e Malishevës .....	25
5.2 Të gjeturat e hulumtimit .....	25
5.2.1 Potenciali i zhvillimit të këtij sektori .....	28
5.2.2 Punësimi në sektorin e grumbullimit dhe përpunimit të BM dhe FM .....	29
5.3 Sfidat dhe nevojat në zhvillimin e biznesit.....	29
5.3.1 Kushtet e zhvillimit të biznesit.....	29

5.3.2	Resurset njerëzore.....	30
5.3.3	Vendet dhe pajisjet për mbajtjen dhe ruajtjen e produkteve.....	30
5.3.4	Cilësia e produkteve të vjela .....	30
5.3.5	Rrjetëzimi dhe krijimi i lidhjeve të reja biznesore .....	30
5.3.6	Mungesa e informacioneve lidhur me tregun - eksporti .....	31
5.3.7	Prezencë e ulët në tregun vendor.....	31
5.3.8	Vetëdijesimi i popullatës për rëndësinë e pyjeve si burim të të ardhurave .....	31
<b>6.</b>	<b>Konkluzionet dhe rekomandimet (e përbashkëta për dy vendet) .....</b>	<b>33</b>
<b>7.</b>	<b>Referencat.....</b>	<b>35</b>
<b>8.</b>	<b>Shtojca A - Bizneset e Shqipërisë .....</b>	<b>37</b>
<b>9.</b>	<b>Shtojca B - Bizneset në pjesën e Kosovës .....</b>	<b>41</b>
<b>10.</b>	<b>Shtojca C - Metodologjia .....</b>	<b>44</b>
<b>11.</b>	<b>Shtojca D - Pyetësi .....</b>	<b>45</b>

# 1. LISTA E SHKURTESAVE

---

<b>APPK</b>	Agjensioni i Përkrahjes Punësimit në Kosovë
<b>ARZM</b>	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BM</b>	Bimë Mjekësore
<b>DLDP</b>	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal
<b>DRB</b>	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
<b>FM</b>	Fruta të Malit
<b>INSTAT</b>	Instituti Statistikave në Shqipëri
<b>ISI</b>	Instituti për Studime Ndërkombëtare
<b>SNV</b>	Organizata Holandeze e Zhvillimit
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

## 2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

**Q**ëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të identifikojë punëdhënësit në sektorin e frutave të malit dhe bimëve mjekësore në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë, nevojat e punëdhënësve dhe potencialin zhvillimor të kësaj fushe. Ky hulumtim do të jetë bazë e mirë për t'u përdorur nga institucionet dhe organizatat e ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë për programimin e mbështetjes së këtij sektori në të ardhmen.

Hulumtimi është pjesë e projektit SWEI - "Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik", projekt i programit për bashkëpunim ndër-kufitar Shqipëri-Kosovë i financuar nga Bashkimi Evropian e i cili implementohet nga APPK - Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë dhe ISI - Instituti për Studime Ndërkombëtare në Shqipëri.

Projekti SWEI është dizajnuar me qëllim që të nxisë bashkëpunimin, shkëmbimin e përvojave, përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së Shërbimeve të Punësimit dhe Qendrave të Aftësisë Profesionale për punësim të qëndrueshëm të punëkërkuësve, trajnimin e të rinjve për të mbështetur integrimin socio-ekonomik në rajonin ndër-kufitar Shqipëri-Kosovë.

Të dhënat e nxjerra nga hulumtimi tregojnë se rajoni ndërkufitar mes Kosovës dhe Shqipërisë është një rajon me potencial të lartë zhvillimor për fruta të malit dhe bimëve mjekësore. Raporti po ashtu tregon se ka një numër relativisht të madh të bizneseve të kësaj veprimtarie dhe një numër edhe më të madh të pikave të vogla grumbulluese.

*Nga të gjeturat kryesore të raportit, që kanë të bëjnë me sfidat dhe nevojat e bizneseve janë:*

- **Kushtet e të bërit biznes:** interesi i lartë i kredive të bankave komerciale, mungesa e përkrahjes së nevojshme institucionale në faza të ndryshme të zhvillimit të biznesit, mungesa e kapaciteteve për të aplikuar në grante të ndryshme zhvillimore;
- **Mungesa e pajisjeve:** Në përgjithësi ka mungesë të pajisjeve për ruajtje, tharje apo paketim të produkteve. Kjo sidomos është më relevante për rajonin Lezhë dhe Kukës (Shqipëri) edhe pse është paraqitur si sfidë edhe nga bizneset e Kosovës (pjesë të këtij hulumtimi);
- **Mungesa e depove:** Bizneset kanë mungesë të depove/vendeve për mbajtje të produkteve për një kohë të caktuar deri në shitje apo/edhe eksport;
- **Rrjetëzimi:** Krijimi i raporteve të reja biznesore, duke përfshirë edhe bizneset me veprimtari të njëjtë në rajon, sigurimi i tregut të qëndrueshëm të shitjes së produkteve;
- **Marketingu:** Mungon kapaciteti i bizneseve për promovim të produkteve dhe në veçanti cilësisë së shtuar të produkteve organike;

- **Trajnimet/ngritja e kapaciteteve:** Grumbulluesit kanë nevojë të trajnohen për kohën dhe mënyrën e mbledhjes së produkteve dhe mirëmbajtjes; bizneset po ashtu kanë nevojë për staf të trajnuar për përpunim të FM dhe BM, staf profesional si menaxherë, kontabilistë dhe profesionistë të tjerë të cilët do të iu ndihmonin në të gjitha aspektet dhe fazat e zhvillimit të biznesit;
- **Ngritja e vetëdijes së popullatës:** Në përgjithësi, ka mungesë të interesimit të banorëve, sidomos të rinjve për të punuar në këtë sektor. Kjo është më relevante për pjesën e Kosovës. Ndërsa, për pjesën e Shqipërisë sfida është shpopullimi dhe imigrimi i të rinjve;
- **Konkurrenca e pabarabartë në treg:** Ka lëvizje të vazhdueshme të çmimit të produkteve në treg dhe kjo i dekurajon grumbulluesit dhe sidomos fermerët që kultivojnë këto produkte.

### 3. HYRJE

---

**K**y hulumtim është zhvilluar në periudhën Tetor – Nëntor 2018. Janë zhvilluar intervista të thella, gjysmë të strukturuar me punëdhënësit kryesor të komunave/bashkive të përcaktuara në projekt, e që për pjesën e Kosovës janë komunat Prizren, Dragash, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Mamushë, ndërsa për Shqipëri janë zhvilluar në rajonin e Lezhës dhe Kukësit.

*Objektivat kryesore të hulumtimit që janë prezantuar në këtë raport ishin që të:*

- a)** Identifikohen ndërmarrjet, punëdhënësit apo pikat grumbulluese të cilat merren me Frutat e Malit dhe Bimët Mjekësore në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë, që përfshinë rajonin e Kukësit dhe Lezhës në Shqipëri, ndërsa në Kosovë komunat: Prizren, Dragash, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Mamushë.
- b)** Identifikohen nevojat e punëdhënësve në fushën e mbledhjes, kultivimit dhe përpunimit të FM dhe BM për të zvogëluar zbrazësitë në mes të Kërkesës dhe Ofertës në treg.
- c)** Vlerësohet potenciali zhvillimor në fushën e mbledhjes, kultivimit dhe përpunimit të FM dhe BM në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë.

Procesi i identifikimit të bizneseve ka qenë gjithëpërfshirës. Në fillim janë kontaktuar komunat/bashkitë përkatëse, agjencitë pyjore dhe departamentet e pylltarisë brenda këtyre institucioneve. Për shkak se komunat/bashkitë në shumicën e rasteve nuk posedojnë një listë të bizneseve që merren me veprimtarinë e bimëve mjekësore dhe frutave të malit, identifikimi i një biznesi zakonisht ka ndihmuar në identifikimin e bizneseve tjera. Nga lista e përzgjedhur e komunave/bashkive për këtë hulumtim, vetëm në komunën e Mamushës (Kosovë) dhe Bashkinë e Hasit (Shqipëri) nuk janë identifikuar ndonjë biznes që merret me këtë veprimtari. Ky përfundim është nxjerrë edhe pas kontaktimit me zyrtarët komunal/bashkiak dhe bizneset tjera të rajonit të Prizrenit dhe Kukësit.

Në total janë intervistuar 27 biznese; 18 në rajonin e Kukësit dhe Lezhës dhe 9 në pjesën e Kosovës.

Për qëllim të këtij hulumtimi vetëm përfaqësuesit e bizneseve (punëdhënësit) të regjistruar në komunat/bashkitë e caktuara janë selektuar. Informatat për grumbulluesit janë marrë nga bizneset, me të cilët ata kanë kontrata bashkëpunimi. Vlen të theksohet se jo të gjithë grumbulluesit kanë kontrata me bizneset, dhe këtë e konfirmojnë edhe bizneset e intervistuar.



Grumbulluesit janë njerëzit/familjet e zonave rurale, kryesisht afër zonave pyjore që kanë potencial për grumbullimin e frutave të malit dhe bimëve mjekësore. Varësisht prej kërkesës dhe çmimit, grumbulluesit mbledhin produkte të ndryshme gjatë ditës dhe në mbrëmje, apo pas një periudhe kohore të shkurtër i shesin ato në pikat grumbulluese, apo edhe në bizneset që bëjnë përpunimin e tyre direkt. Në shumicën e rasteve, bizneset bëjnë transportimin e produkteve nga vendet ku është grumbulluar në depot kryesore.

Shumica e produkteve të grumbulluara shiten gjatë ditës, dhe në shumë pak raste grumbulluesit i thajnë produktet që i mbledhin apo i pastrojnë ato. Kjo për shkak të mungesës së pajisjeve për të bërë një gjë të tillë.

## 4. SHQIPËRIA

Shqipëria për vetë pozicionin gjeografik në të cilin ndodhet, si dhe kushtet e favorshme fiziko-gjeografike renditet ndër vendet e para evropiane për pasuritë floristike. Në Shqipëri rriten rreth 47% e llojeve të bimëve të Ballkanit dhe 30% e llojeve të bimëve të Evropës. Flora e Shqipërisë përfshin rreth 3 250 specie të ndryshme bimore të cilat u përkasin 165 familjeve dhe 910 gjinive. Rreth 1.1% ose 28 specie dhe 150 subspecie janë endemike.<sup>1</sup> Rreth 300 specie janë bimë mjekësore dhe aromatike dhe rreth 10 % të florës së Shqipërisë e zënë speciet e rralla, speciet në rrezik zhdukje dhe llojet relikte.<sup>2</sup>

Flora e Shqipërisë përbën një potencial të konsiderueshëm të biodiversitetit me vlera ekologjike dhe ekonomike. Bimët mjekësore dhe aromatike që rriten në Shqipëri kanë një potencial të konsiderueshëm dhe 90% e tyre rriten në gjendje natyrale. Zakonisht bimët aromatike dhe mjekësore mbledhen nga familjet që jetojnë në zonat rurale. Pjesëtarë të këtyre familjeve mbledhin bimët e egra, të cilat më tej dorëzohen në pikat e grumbullimit të rreth 30-40 kompanive vendase.

### 4.1 Potencialet e Bimëve Mjekësore

Gjatë 10 viteve të fundit, si pasojë e rritjes së kërkesës për produkte shqiptare në tregjet ndërkombëtare, sektori është rritur si në sasi të produkteve të eksportuara, ashtu edhe në cilësinë e tyre. Kompanitë shqiptare, furnizues të këtyre produkteve në tregjet ndërkombëtare kanë forcuar pozicionet e tyre në këto tregje, kanë fituar eksperiencë dhe kanë krijuar një rrjet të fuqishëm lidhjesh. Një peshë të rëndësishme në kontingjentin e bimëve mjekësore dhe frutave të malit e zënë rajonet e Kukësit dhe Lezhës. Vetëm në rajonin e Lezhës ushtrojnë aktivitet dy kompanitë më të mëdha në vend që grumbullojnë e tregtojnë bimë mjekësore.

Frutat më të njohura të malit në rajonin e Kukësit dhe Lezhës janë gështenja, shega e egër, boronica, manaferrat, mjedra dhe luleshtrydhet. Tropoja disponon një sipërfaqe prej 2000 hektarësh me gështenja dhe Kukësi disponon një sipërfaqe prej 700 hektarësh, duke e bërë kështu si masivin më të madh në Ballkan me një prodhim prej afro 4 mijë ton në vit.

Boronica mbledhet e njomë dhe tregtohet më së shumti në gjendje të thatë. Llogaritet se vetëm Kukësi dhe Tropoja prodhojnë rreth 80 ton boronicë. Problematika kryesore që ka lidhje me këtë produkt është ruajtja e boronicës në dhoma frigoriferike. Për shkak të mungesës së dhomave frigoriferike, boronica mbledhet nga fermerët dhe thahet në gjendje natyrore nga vetë ata, e më pas dërgohet tek grumbulluesit.

Nga rreth 2,300-2,400 ton gështenja që mbledhen në vit në rrethin e Tropojës, vetëm rreth 75% e tij destinohet për treg, ndërsa pjesa tjetër ose përdoret për konsum ose dëmtohet pa u tregtuar/

<sup>1</sup> Bimët mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë, Tiranë 1976, fq.5

<sup>2</sup> Vangjeli J, Ruci B, Mullaj A. Libri i Kuq, Tirane 2007 fq.6

përpunuar fare. Sipas informacionit të grumbulluar nga burimet lokale (specialistet, fermerët dhe grumbulluesit lokal), destinacionet kryesore të prodhimit jepen përafërsisht në skemën e mëposhtme:

## 4.2 Rajoni Lezhës

Qarku i Lezhës është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqe prej 1.588 km<sup>2</sup>. Qarku i Lezhës i përfshin Bashkinë e Kurbinit, bashkinë e Lezhës dhe bashkinë e Mirditës. Qendra e Qarkut të Lezhës ndodhet në qytetin e Lezhës. Qarku i Lezhës kufizohet në veri me Qarkun e Shkodrës, në verilindje me Qarkun e Kukësit, në lindje me Qarkun e Dibrës, në jug me Qarkun e Durrësit dhe në perëndim me Detin Adriatik.


Qarku i Lezhës ka një popullsi prej 158.377 banorë. Ekonomia e rajonit bazohet në bujqësi dhe turizëm (zona e Shëngjinit). Administrata vendore e zonave të mbrojtura informon se janë rreth 2000 familje që mbledhin bimë mjekësore dhe fruta pylli në të gjithë rajonin. Kryesisht janë femra dhe vetëm një pjesë meshkuj.

Karakteristikat natyrore të relievit të rajonit Lezhës, klima e, veçoritë e tokës e të tjerë, kanë kondicionuar një variacion të mrekullueshëm të florës, habitate të larmishme të pasura me lloje, e në mënyrë të veçantë dhe më bimësi mjekësore, e eterovajore.

Nga studimet e bëra rezulton se sipërfaqja totale e shpërndarjes së tyre është 7737 ha. Numri i llojeve me gradë të lartë mbulimi, më të kërkuar për treg etj., e më të identifikuar janë 23, ku përmendim Sherbelën, Trumzën, Zhumbricën, Dëllinjën e kuqe, Trëndafili i egër, Mërsina etj.

Këto bimë natyrore spontane që rriten të bashkëshoqëruara më bimësi pyjore ose dhe të veçuara shpesh formojnë dhe formacion në vete. Kapaciteti i tyre prodhues (i drogave bimore) ndryshon nga viti në vit në vartësi të karakteristikave të klimës, të ndërhyrjeve të ndryshme në këtë fond etj. Nga llogaritjet rezulton se prodhimi i përgjithshëm i bimëve mjekësore aromatike është 923 ton/vit mase e thatë, ku peshën kryesore e zë sherbela më 562 ton, trumza më 233 ton/vit, zhumbrica ose lisra me 83 ton, ndërsa pjesa e tjetër përbëhet nga lloje të tjera<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Administrimi Bimëve Mjekësore – Jak Gjini, Lezhe 2018.



**FIGURA 1.** Bimët natyrore spontane

Kapacitetet natyrore prodhuese e të menaxhuara në mënyre korrekte janë më të mëdha se ato që kërkon tregu sot si në numrin e llojeve, produkteve dhe përbën një bazë të fuqishme për fuqizimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti. Sherbela është një potencial natyror zhvillimor dhe për veçoritë specifike që ka kjo bimë, si përqindja e lartë e vajit eterik, tujonit (në Lezhë 32%, sa dyfishi i asaj të jugut). Diversiteti i lartë i llojeve është shumë më i lartë se ai që qarkullon në treg. Ka shumë lloje që akoma nuk e kanë gjet veten në treg megjithëse kanë kërkesa sidomos në tregun e huaj.

### 4.3 Rajoni Kukësit

Qarku i Kukësit është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqe prej 2.373 km<sup>2</sup>. Qarku i Kukësit i përfshin bashkinë e Hasit, bashkinë e Kukësit dhe bashkinë e Tropojës. Kryeqendrat sipas rretheve janë: Kukësi, për rrethin Kukës, Kruma për rrethin Has dhe Bajram Curri (ish-Kolgecaj) për rrethin Tropojë. Qarku i Kukësit kufizohet në verilindje dhe deri në lindje me Kosovën, në jug me Qarkun e Dibrës, në jugperëndim me Qarkun e Lezhës, në perëndim me Qarkun e Shkodrës dhe në veriperëndim me Malin e Zi. Rajoni ka rreth 107 mijë hektarë me pyje dhe 46 mijë hektarë kullota natyrore. Në to, rriten në formë natyrore, të egër më shumë se 1600 lloje të bimëve, prej të cilave më shumë se 80 lloje bimësh janë mjekësore. Nga këto bimë mjekësore, rreth 40 prej tyre grumbullohen.

Qarku i Kukësit ka një popullsi prej 117 .000 banorë. Ekonomia e këtij rajoni bazohet kryesisht në blegtori, bujqësi dhe turizëm (zona e Valbonës). Nga studimet në terren dhe informacioni që ofron administrata vendore rezulton se janë rreth 3 000 familje që mbledhin bimë mjekësore dhe fruta mali. Nga intervistat rezulton se 70 % e tyre janë femra dhe 30 % janë meshkuj, kryesisht të rinj..

Potenciali natyror i bimëve mjekësore dhe aromatike që ky rajon disponon e bën atë një ndër rajonet me biodiversitetin më të madh të këtyre bimëve. Lartësitë variojnë nga 380 m (lugina e Drinit të Zi) deri në rreth 2400 m (maja e Gjallicës). Aktualisht edhe rrethi Kukës renditet ndër vendet kryesore ku grumbullohen për eksportin e bimëve mjekësore dhe aromatike (boronicë, trumzë, rigon, çaj mali, mollë e egër, trëndafil i egër, aguliçe, dëllinjë e zezë, shtog, hithër, lulëkuqe, salep, kamomil, shpatore, etj.).

Kukës (Kukës, Has, Tropojë): rigoni me sipërfaqe 1600 ha dhe me sasi 86 ton, sherbela me sipërfaqe 783 ha dhe me sasia 192 ton, trumza me sipërfaqe 1190 hektarë dhe me sasi 52 ton<sup>4</sup>.

Po kështu në shkallë rajoni mblidhen çdo vit masë e thatë : 100 ton gjethe mështekne, 90 ton lule balsami, 40 ton dëllinje e zezë, 30 ton trëndafili egër, 10 ton dëllinjë e kuqe, dhe rreth 60 ton bimë të tjera si lule shtogu, aguliçe, kulumbri, çaje mali, sanëza, gjethe blini, dhe rrënjë hithre<sup>5</sup>

Të dhënat mbi potencialet e bimëve mjekësore kryesore që grumbullohen për zonën e mbrojtur Korab Koritnik, në sipërfaqen që shtrihet në rrethin Kukës.

**TABELA 1.** Potencialet e bimëve mjekësore kryesore

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Komente
1	Sasia e bimëve mjekësore të grumbulluara në vit (para 1990)	ton	850	Sasia është përlogaritur në bazë të dhënave të ndërmarrjes shtetërore të grumbullimit
2	Sasia e bimëve mjekësore që grumbullohen sot (viti 2017)	ton	232	E dhëna bazohet në deklaratimet e grumbulluesve që ka rajoni.
3	Numri i subjekteve që merren me grumbullimin e bimëve mjekësore	subjekte	4	
4	Numri i pikave të grumbullimit (magazina grumbullimi)	magazina	3	

*Burimi: Administrata rajonale e zonave të mbrojtura - Kukës 2018.*

Në kuadër të zhvillimit të ekonomisë edhe bimët mjekësore dhe aromatike zënë një peshë të rëndësishme në të ardhurat që sigurohen nga këto produkte. Zona ka një traditë të hershme të mbledhjes dhe përdorimit të bimëve mjekësore dhe aromatike. Mbledhja, grumbullimi dhe tregtimi i tyre luajnë një rol të konsiderueshëm në gjenerimin e të ardhurave për banorët e zonave rurale të këtij rajoni.

Aktualisht edhe rrethi Kukës renditet ndër vendet kryesore ku grumbullohen për eksportin e bimëve mjekësore dhe aromatike (boronicë, trumzë, rigon, çaj mali, mollë e egër, trëndafil i egër, aguliçe, dëllinjë e zezë, shtog, hithër, lulëkuqe, salep, kamomil, shpatore, etj.).

<sup>4</sup> Potencialet natyrore të bimëve aromatike-mjekësore në Shqipëri

<sup>5</sup> Programi ProMali – SNV , viti 2011,

Relievi i larmishëm dhe klima kanë ndikuar në krijimin e mikrozonave, të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e ekosistemeve të pasura në llojshmëri biologjike. Kësisoj kemi edhe një shumëllojshmëri të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere.

Në Kukës njihen 45 lloje drurësh dhe shkurresh mjekësore dhe 83 lloje bimë mjekësore por numri tyre është edhe më i madh. Numri i llojeve të bimëve që grumbullohen aktualisht është rreth 30. Bimët mjekësore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë ekonomi familjare në fshatra. Në rrethet Kukës dhe Has dhe Tropojë ka pasur një traditë të hershme të mbledhjes dhe grumbullimit të tyre. Grumbullimi bëhet nga ish ndërmarrja e grumbullimit dhe destinacioni kryesor ishte eksporti. Në disa ish kooperativa si në Arrën, Shemri, Surroj kanë qenë të ngritura impiante distilimi të gjetheve të pishës dhe rrëshirës, për prodhimin e esencave. Aktualisht bimët mbledhen kryesisht nga banorë të fshatrave në territoret e të cilëve ato ndodhen dhe pastaj grumbullohen nga tregtarë lokal apo të tjerë, e jo të gjithë janë të licencuar. Fermerët lokalë nuk i kultivojnë këto bimë por thjesht i mbledhin në natyrë. Vitet e fundit janë kultivuar rreth 60 hektarë bimë mjekësore, kryesisht sherbele, dhe *Gentiana lutea*.

**TABELA 2.** Lloji i bimëve që grumbullohet

Lloji i bimëve që grumbullohet	Kukës	Has	Tropojë	Total
<b>(ton/vit)</b>				
Mështekna	60	-	-	60
Boronica	40	-	40	80
Dëllinja e zeze	70	-	40	110
Trëndafili egër	30	-	20	50
Molla e egër	50	10	30	90
<b>Total</b>	<b>250</b>	<b>10</b>	<b>120</b>	<b>380</b>

*Burimi: Strategjia e Zhvillimit Qarkut Kukës 2012-2016.*

#### 4.4 Të gjeturat nga tereni: Sfidat dhe nevojat në zhvillimin e veprimtarisë

Në Shqipëri, deri në vitin 1990 bimët mjekësore janë menaxhuar dhe administruar vetëm nga ndërmarrjet shtetërore e konkretisht nga Drejtoritë e pyjeve dhe kullotave dhe ndërmarrjet e grumbullimit. Pas viteve 1990, bimët mjekësore janë menaxhuar dhe administruar vetëm nga sektori privat. Pavarësisht se territoret ku rriten bimët mjekësore dhe frutat e malit në mënyrë natyrore administrohen nga institucione shtetërore, sikurse janë Administrata Rajonale e Zonave të mbrojtura (ARZM) apo Drejtoritë e Pyjeve dhe kullotave pranë Bashkive, asnjëherë këto të fundit nuk kanë mundur të menaxhojnë dhe kontrollojnë në mënyrën e duhur këtë sektor të rëndësishëm.

*Sektori privat që u krijua pas viteve 1990 kishte këto kategori :*

- mbledhësit/vjelësit – fermerët;
- konsoliduesit/ grumbulluesit në rrethe
- eksportuesit e mëdhenj

Për sa i takon inventarit dhe të dhënave për grumbulluesit e bimëve mjekësore, deri në hulumtimin e këtij studimi , asnjë nga institucionet apo organet vendore nuk kishte një sistem të dhënash të detajuar që lidheshin me këto biznese.

#### **4.4.1. Identifikimi i ndërmarrjeve, që merren me Frutat e Malit dhe Bimët Mjekësore**

Nga verifikimi në vend rezulton se në rajonin e Kukësit ushtrojnë veprimtarinë 8 biznese që merren me grumbullimin e bimëve mjekësore dhe frutave të malit, nga të cilat 4 biznese në bashkinë Tropojë dhe 4 biznese në bashkinë Kukës. Vetëm bashkia e Hasit nuk ka biznese që grumbullojnë bimët mjekësore. Pavarësisht se ka me dhjetëra familje në rrethin e Hasit që mbledhin këto bimë, për shkak të distancës së afërt, ata e dërgojnë produktin direkt e tek grumbulluesit në Kukës. Grumbulluesit e këtij rajoni merren me mbledhjen e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit sipas kërkesave që ka tregu. Ata i marrin produktet në gjendje të thatë, për shkak se nuk disponojnë pajisje tharëse apo frigoriferë.

Dy vitet e fundit, këto biznese kanë bërë investime dukë ndërtuar dhe rikonstruktuar magazina dhe depo me kapacitete të mëdha. (Rasti i biznesit Hallaçi në Kukës dhe dy bizneseve (Milushi, Zeneli) në Tropojë.

Bimët mjekësore që ata grumbullojnë dhe frutat e malit janë tërësisht organike dhe natyrore dhe vilen në pyll. Bizneset janë të lidhur (pa kontratë formale) me qindra familje që mbledhin produktet natyrore dhe bëjnë likuidimin e mallit që marrin në varësi të mundësisë së shlyerjes që ato kanë.

Numri i punonjësve tek këto biznese është sezonal dhe varion nga 4 – 6 veta, në varësi të prodhimit dhe kërkesave të eksportuesve të mëdhenj. Nuk bëjnë eksporte jashtë vendit ,(në përjashtim të një grumbulluesi në Tropojë- “Berbati”), por kanë bashkëpunim të mirë me bizneset e Kosovës. Këta të fundit vijnë dhe e marrin vetë mallin në magazinat e prodhuesve.

Shqetësimi kryesor i tyre është mungesa e pajisjeve tharëse për bimët mjekësore dhe frigoriferëve për frutat e malit.

Në rajonin e Lezhës ushtrojnë veprimtarinë 9 biznese të bimëve mjekësore , e konkretisht : 4 biznese në bashkinë e Lezhës, 3 biznese në Bashkinë e Kurbinit dhe 2 biznese në bashkinë e Mirditës.

Në këtë rajon kanë vendndodhjen dy eksportuesit më të mëdhenj në Shqipëri të bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit (Filipi Company, dhe Daci Company). Numri total i punonjësve të këtyre dy kompanive është rreth 250 veta me kohë të plotë. Bizneset e tyre kanë kapacitete të mëdha

depozitimi dhe eksportojnë produktet kryesisht në Amerikë dhe vendet e Bashkimit Evropian. Gjithsesi produktin e marrin nga fermerët në gjendje të thatë dhe për rrjedhojë sipas tyre, në shumë raste ka krijuar probleme në cilësinë e mallit. Mungesa e laboratorëve dhe mungesa e njohurive të mbledhësve të bimëve, ka vështirësuar në disa raste shitjen e këtyre produkteve jashtë vendit.

Bizneset e tjera të rajonit Lezhës kanë kapacitete mesatare. Grumbullimi i bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit bëhet në gjendje të thate, pasi nuk disponojnë makineritë e nevojshme për tharjen e manipulimin në vend të produkteve. Produkti që ato grumbullojnë është 90 % natyror dhe 10 % i kultivuar.

Dy kompani (Filipi company dhe Çupi) prodhojnë edhe vajra eterike, por sipas Çupit, teknologjia e nxjerrjes së vajrave është e vjetruar për shkak të mungesës së teknologjisë që ata disponojnë.

Nga intervistat, këto biznese theksojnë se ka rritje të aktivitetit dhe interesi është rritur qoftë nga fermerët qoftë edhe nga kompanitë evropiane për produktet shqiptare.

#### 4.4.2 Shpopullimi, cilësia e produkteve

Shpopullimi i zonave rurale, veçanërisht i fshatrave në zonat malore të Kukësit, Hasit e Tropojës, si pasojë e lëvizjes së popullsisë drejt qyteteve. Kjo ka bërë që territore me potenciale të mëdha shfrytëzimi mbeten ende të paprekura. Shpesh herë kapacitetet e pamjaftueshme në ambientet e tharjes ndikojnë në uljen e cilësisë dhe standardevë. Rritja e kërkesës për bimë mjekësore dhe aromatike është një sfidë për industrinë e prodhimit të këtyre bimëve, të cilave u duhet të menaxhojnë sasinë e kërkuar kundrejt cilësisë.

Standardet ndërkombëtarë të cilësisë përbëjnë një nga sfidat më të rëndësishme, sepse një pjesë e mirë e produkteve të mbledhura prej popullsisë së zonave rurale përmban gurë dhe barishte. Grumbulluesit duhet të investojnë në përfundimin e njohurive të duhura dhe teknologjisë që do të ulte sasisë e mbetjeve dhe do të rriste cilësinë e produkteve të tregtuara. **Shpesh herë mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi biologjinë e rritjes dhe të zhvillimit të këtyre bimëve apo mbi fazën e duhur biologjike, atëherë kur bimët kanë arritur pikën më të lartë të vajit esencial. Për rrjedhojë, bimët mblidhen pa kriter duke e shkullur edhe me rrënjë.** Aktivitete të ndryshme njerëzore të ushtruara në natyrë, siç janë shpyllëzimet, mbikullotja, vënia e zjarreve të qëllimshme si dhe mbishfrytëzimi i bimëve mjekësore për arsyeje ekonomike. Nisur nga kushtet specifike të rritjes së bimëve spontane, shpeshherë shpyllëzimet ndikojnë në dëmtimin dhe zhdukjen e disa llojeve specimesh si pasojë e prishjes së habitatit të tyre të rritjes.



#### 4.4.3 Mungesa e trajnimeve

Vjelësit në shumicën e rasteve janë të patrajnuar dhe përdorin metoda të ndryshme të vjeljes si shkuljen me vegla të forta (kazma), ku pjesa e bimës që përdoret është rrënja, duke e bërë atë të padobishme për vitin e ardhshëm. Në raste të tjera përdoret prerja e një bime në rrëzë të saj, kur pjesa që nevojitet është vetëm lulja ose gjethet e saj.

Në rastin e dëllinjës, të cilës i përdoren vetëm frytet e saj, kokrrat e pjekura dhe bima duhet të shkunden shumë lehtë, por në shumicën e rasteve ato shkunden duke përzier kokrrat e pjekura me ato të papjekura, gjë që ndikon dhe në cilësinë e prodhimit për treg. Për këtë arsyeje disa bimë si: rigoni i bardhë, (salepi) apo *Gentiana lutea* (sanëza) me vlera të veçanta mjekësore, është pothuajse plotësisht i zhdukur dhe trumza është në pakësim. Këto janë ndër bimët më të kërkuara sot në treg janë mbishfrytëzuar duke ndërprerë prodhimin për vitin pasardhës.

#### 4.4.5 Konkurrencë e pabarabartë në treg

Kultivues dhe grumbullues të bimëve mjekësore në Kukës, thonë se tregu është i deformuar dhe të ardhurat nuk shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe të ndershme nga eksportuesit në hallkat e poshtme dhe sidomos me fermerët që mbjellin e kultivojnë bimët mjekësore. **Ata shprehën se sektori do të mund të rregullohet dhe të maksimizojnë fitimet vetëm nëse formalizohet dhe nis e punon me kontrata.**

Fermerët gjatë intervistave theksojnë se eksportuesit trajtojnë me çmime të ndryshme grumbullues të ndryshëm për të njëjtën bimë. Çmimet shpesh vihen nga telefoni, pa asnjë garanci dhe pagesat nuk kryhen në kohë ndaj fermerëve. Sipas grumbulluesve të rrethit Tropojë, operimi me kontrata në sektor është emergjencë për të garantuar së pari të ardhurat e mijëra familjeve shqiptare që janë përfshirë në biznesin e bimëve mjekësore dhe janë nga shtresat më të varfra të Shqipërisë.

Një aspekt problematik që është vënë në pah nga hulumtimi ka lidhje me moslëvrimin e pagesave dhe krijimi i borxheve të papaguara zinxhir. Grumbulluesit e mëdhenj nuk mund ti shlyejnë pagesat për grumbulluesit e vegjël që janë në rrethe, dhe këta të fundit nuk i shlyejnë pagesat për mbledhësit e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit. Për rrjedhojë, fermerët, dekurajohen dhe nuk mbledhin vitin tjetër, për shkak të pasigurisë që kanë në marrjen e pagesave.

### 4.5 Sfidat tjera të identifikuara

Specialistët e zonave të mbrojtura theksojnë se rënia e prodhimit të sherbelës është në masën rreth 18% si dhe 4% e trumzës e 2% e listrës. Bima e sanëzës dhe salepit janë duke shkuar drejt minimumit kritik. Vazhdimi i përkeqësimit të shoqërimeve bimë të rrezikuara si ai i shegës së egër, degradimi i fondit natyror të bimëve mjekësore është i kushtëzuar nga:

- Shfrytëzimi disa vjeçar pa kriter dhe në mënyrë intensive. Vërehet ulje deri në 10 herë më pak të prodhimit në krahasim me vitet me prodhim më të mirë.

- Mosnjohja e moszbatimi i kushteve teknike të mbledhjes e trajtimit të bimëve mjekësore. (mblidhen dhe bimët e reja, nuk ndalohet mbledhja 1 herë në 3-4 vjet për t'u përtërirë e të mos zhduken nga përbërja floristike sipas rekomandimeve të specialistëve etj.).
- Ndërhyrja në shfrytëzimin e fondit pyjor në mënyrë të pastudiuar dhe abuzive nga subjektet e ndryshme (Prishja e habitateve nga aktivitete që ndikojnë në shpyllëzimet, nga mbikullotja, aktivitetet e nxjerrjes së gurit etj.).
- Legjislacioni e zbatimi i tij nuk garanton shumë mbrojtje. (Licencimi, zbatimi i kushteve teknike).
- Konkurrenca midis subjekteve dhe individëve që mbledhin bimët mjekësore ka rritur mbishfrytëzimin e bimëve mjekësore.
- Mbledhja e pak kulturave mjekësore kryesisht për arsye tregu duke ju dhënë pak mundësi individëve të papunë e në nevojë.
- Mosangazhimi si duhet i pushtetit vendor për mbrojtjen e bimëve mjekësore si vlera natyrore të pazëvendësueshme dhe në përgjithësi për problematikat mjedisore.
- Mungesa e monitorimeve dhe si rezultat mosnjohja e saktë e gjendjes së bimëve mjekësore.
- Mungesa e sensibilizimit për shfrytëzimin racional e për njohjen e kushteve teknike të mbledhjes.
- Niveli i ulët i mirëqenies, varfëria dhe të ardhurat minimale.
- Zbehja e sensibilitetit të komunitetit për përdorimin e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit, mungesa e njohjes në këtë drejtim, literature e paket dhe e vjetër etj.
- Nxënësit e të rinjtë kanë pak njohuri për bimët mjekësore, programet shkollore nuk japin njohuri të mjaftueshme në këtë drejtim. Vërehet mangësi në njohjen e nxënësve me bimët mjekësore të zonës.
- Kushtet klimaterike jo shumë të favorshme disa vjeçare (thatësira e tejzgjatur).
- Mungesa e teknologjive të manipulimit: tharje, ruajtja dhe ambalazhimi nuk bëhet sipas kërkesave.
- Nuk stimulohen fermerët nga programet qeveritare apo donatorët për kultivimin e bimëve mjekësore në zhdukje. Përmendim rastin e kultivimit të Gentianës në Shishtavec të Kukësit

#### **4.6 Nevojat e punëdhënësve për të zvogëluar zbrazësitë në mes të kërkesës dhe ofertës.**

- Rritje të kapaciteteve financiare për ndërtim magazinash e reparte përpunimi, presave, pajisjeve për tharje, frigoriferëve etj.
- Mbështetje financiare për ndërtimin e laboratorëve për kryerjen e analizave shumë të domosdoshme për tregun e huaj.
- Krijimi i lidhjeve direkte me tregun e huaj (kjo për grumbulluesit e vegjël). Kjo ka të bëjë me kapacitetet, sepse grumbulluesit kanë më shumë besim tek lidhja direkte se sa ti shesin tek grumbulluesit e mëdhenj.
- Incentiva për rritjen e fitimit të grumbulluesit pasi po ndjehet mungesa e fuqisë punëtore në vjeljen e bimëve e frutave spontane në disa zona.
- Mbështetja ligjore për mos-fragmentarizmin e ekonomive pyjore nga pronarët pretendues dhe vënia në funksion e këtyre ekonomive për bimë mjekësore.

- Mbështetja dhe kontrolli për respektimin e kriterëve teknike të mbledhjes, mbledhja para kohës optimale teknike, e mos-lënia e masës vegjetative ripërtëritëse e asaj riprodhuese.
- Vendosja e kriterëve më të forta për vlerësimin e drogave bio natyrore nga ato të kultivuara. Bimët e kultivuara në malësinë e madhe Shkodër, e kanë ulur shumë çmimin e produkteve, veçanërisht në tregun vendas.

#### 4.7 Grumbullimi, përpunimi dhe tregtimi frutave të malit.

Frutat më të njohur të malit në rajonin e Kukësit dhe Lezhës janë gështenja, shega e egër, boronicat, manaferrat, mjedra dhe luleshtrydhet. Tropoja disponon një sipërfaqe prej 2500 hektarësh me gështenja dhe Kukësi disponon një sipërfaqe prej 700 hektarësh, duke e bërë kështu si masivin më të madh në Ballkan me një prodhim prej afro 4 mije ton në vit.<sup>6</sup>

#### 4.8 Grumbulluesit lokal dhe tregtarët ambulant që tregtojnë gështenjën.

Ne të gjithë rrethin e Tropojës, aktualisht veprojnë rreth 4-6 grumbullues të vegjël të cilët janë të shpërndarë nëpër zona të ndryshme. Gjatë sezonit të prodhimit të gështenjës në Tropojë vijjnë edhe disa tregtarë ambulantë nga zonat e tjera të vendit, të cilët grumbullojnë gështenja nga fermerët apo/edhe nga grumbulluesit lokal, dhe i shesin ato më pas nëpër tregjet e qyteteve kryesore të vendit. Këta grumbullues lokal dhe tregtarë sezonal, ambulantë, grumbullojnë sipas viteve në rreth 35-40% të prodhimit të mbledhur të gështenjës së zonës (ose rreth 750-800 ton/vit në varësi të viteve) dhe i tregtojnë të freskëta, nga të cilat: (a) rreth 45% tregtohet në tregjet e vendit, kryesisht zonat dhe tregjet e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Fierit, Korçës, etj., dhe; (b) rreth 55% tregtohet nëpër tregjet e Kosovës. Gjithashtu, një numër shumë i kufizuar fermerësh (kryesisht ata pak fermerë që disponojnë mjete transporti) e transportojnë vete prodhimin nga Tropoja neper tregjet e vendase (kryesisht Tiranë, Durrës dhe Shkodër) në mënyrë që të sigurojnë një çmim disi më të lartë.

Shitja e gështenjave në Kosovë gjatë këtyre viteve të fundit është vështirësuar gjatë viteve të fundit kryesisht si pasojë e mosfunksionimit siç duhet të pikës doganore të Qafë Morinës dhe vështirësisë së plotësimit të kushteve të dokumentacionit tatimor (atij Shqiptar dhe Kosovar) nga bizneset e vogla grumbulluese që veprojnë në zonë. Si pasojë, gjatë dy viteve të fundit, vërehet një rritje e tregtimit të gështenjës së freskët në tregjet e qyteteve kryesore vendase (si Tirana, Durrësi, Vlora, Fieri, Korça, etj.). Megjithatë edhe këto tregje vendase ngelen shumë spontane dhe të pasigurta, gjë që e kombinuar me mungesën e mundësive dhe kapaciteteve të ruajtjes së prodhimit për një periudhë kohe e vështirëson shumë sigurinë e veprimtarisë së grumbullimit nga këta aktorë të tregut.

<sup>6</sup> Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Kukës. Viti 2018

## 4.9 Grumbulluesit dhe përpunuesit e gështenjës.

Për sa i përket përpunimit, pavarësisht disa tentativave nga 2-3 biznese lokale, aktualisht në Tropojë grumbullohen dhe përpunohen rreth 500 – 600 ton/vit (vlerësuar në rreth 20-25% të prodhimit vjetor të zonës ose rreth 45% të prodhimit të tregtuar në vit). Këto sasi grumbullohen nga kompania ose përmes pikave të saj grumbullimit ose përmes dorëzimit direkt në qendrën e përpunimit nga fermerët. Në këtë rast, çmimi i grumbullimit nga ferma është rreth 150-180 lek/kg në varësi të cilësisë së frutave.<sup>7</sup>

Gjatë viteve 2010 -2012 u investua nga një kompani “Ambla” në Tropojë për ngritjen e një qendre përpunimi të gështenjës por investimi mbeti në mes dhe stabilimenti nuk mundi të vihej në punë për shkak të mos mbështetjes së programeve për bujqësinë, donatorëve apo nga Ministria e Bujqësisë. Nëse do mbështetej ky investim do garantohej punësimi i rreth 1000 familjeve tropojane.

Nga informacioni i marre në vend, vërehet se krahas masave të tjera, një rol të dorës së pare e luan përpunimi i frutave të gështenjës në nënprodukte të tjera si: gështenjë e thatë dhe e zhveshur, miell, brum/qulle, të freskëta, etj. Restaurimi në kapacitetet përpunuese i njësisë përpunuese ekzistuese, si dhe ndërtimi i një ose edhe me shumë njësisive të tjera të përpunimit të frutave të gështenjës, vlerësohet si “mjete më shpëtimtar” për këtë produkt.

Me anë të këtij stabilimenti, do të behet e mundur jo vetëm tërheqja totale e gështenjave si lëndë e parë, por ajo që ka më shumë rëndësi është rritja e kapaciteteve ruajtëse/konservuese të lëndës së parë dhe nënprodukteve të tyre, duke siguruar kështu edhe tregtimin e sigurtë të frutave të gështenjave të cilat zakonisht periudhën e vjeljes e kanë shumë të shkurtër dhe pikun e prodhimit mjaft të theksuar (fundi i Shtatorit deri në mesin e Nëntorit).

Nëse do të ndërhyhet në këtë drejtim, mundësia e përpunimit do të tre ose katërfishohet (nga 500-600 ton/vit që aktualisht përpunohet në 3,000 ton/vit brenda një periudhë 3-4 vjeçare. Kjo masë më siguri do të ndikojë në atë që fermerët do ta shikojnë gështenjën si një bimë me shumë interes dhe patjetër që do të kthehen asaj.

### 4.9.1 Produktet e patregtuara

Një sasi e konsiderueshme e prodhimit të gështenjës në këtë zonë (ose rreth 30-40% ose 800-1000 ton/vit) nuk arrin të gjejë treg dhe një shumica e këtij produkti shkon dëm. Kështu sipas vlerësimeve të specialisteve të zonës, rreth 200-300 ton/vit e kësaj sasive konsumohen nga vete familjet e zonës, ndërsa pjesa më e madhe (rreth 600-800 ton/vit) shkon si pasojë e mosgjetjes së tregjeve të shitjes.

<sup>7</sup> Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Kukës, 2018.

#### 4.9.2. Pengesat dhe vështirësitë sipas hallkave të zinxhirit të vlerës

Nga vrojtimit e bëra dhe informacioni i grumbulluar, rezulton se nëpër hallkat e zinxhirit të kësaj veprimtarie (aspektet e prodhimit, grumbullimit, përpunimit, transportit, promovimit, etj.), krahas avantazheve ekzistojnë edhe një mori vështirësish dhe pengesash të cilat ndikojnë direkt negativisht në zhvillimin e kësaj veprimtarie.

*Nga të gjeturat e hulumtimit dhe informacioni i grumbulluar, rezulton se në hallkën e grumbullimit dhe përpunimit ekzistojnë një sërë vështirësish e ato janë:*

- 1) Përderisa mundësia e shitjes së të gjithë produkteve të grumbulluara dhe përpunuara nuk është e sigurtë dhe ajo e sigurimit të një çmimi të kënaqshëm ende nuk është në nivelin e duhur, te shumica e fermerëve është shfaqur dukshëm ndjenja e mosbesimit dhe realisht ata ndjehen të demotivuar.
- 2) Bazuar në faktin se shumica e kashnjeteve<sup>8</sup> nuk janë të privatizuara në bazë ferme/familjeje, por janë të privatizuara në bazë lagjeje/fshati apo të një grupi familjesh (sipas traditave), ka bërë që ndjeja e punës kolektive në drejtim të shërbimeve agroteknike (kryesisht për rrallimet, shkalbëzimet, mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit, mbrojtja nga erozioni, etj.,) nuk janë në nivelin e duhur. Kështu që bimët kanë pësuar devijime vegjetative nga forma të kultivuara në ato të egra dhe/ose ½ të egra dhe prodhimi ka rënë ndjeshëm në mbi 55-65% më pak se kapaciteti i tyre i zakonshëm.
- 3) Mungesa e kujdesit ndaj bimës, vegjetacioni i zhvilluar nën kurorën e bimëve (sepse nuk janë të pastruara), ka ndikuar që të vonohet mbledhja në kohën e duhur e frutave të rena për toke. Kjo ka ndikuar më humbjen e cilësisë së tyre dhe fillimin e infektimit nga larvat e *Carpocapsa pomonella*. Mungojnë mjetet e ruajtjes së frutave për një kohë më të gjatë në kushtet e fermës si kosha, arka speciale, etj., te cilat krijojnë kushte mikroklimatike për një ruajtje më të specializuar.
- 4) Pamjaftueshmëria e fuqisë punëtore, ku të rinjtë në të shumtën e rasteve kanë emigruar dhe nëpër ferma kanë ngelur forca pune që për efekt të moshës edhe pse janë të specializuara mirë, mundësitë fizike të tyre nuk i përballojnë dot nevojat për kryerjen e shërbimeve teknike tek bimët. Mungesa dhe paqëndrueshmëria e tregut mbetet një nga problemet kryesore që dekurajon fermerët për tu kujdesur për kashnjetet. Bazuar nga informacioni që tregtarët (sidomos ata ambulante) luajnë së tepërmi me çmimet e blerjes së frutave nga fermat dhe diferenca ndërmjet çmimit të blerjes dhe asaj të shitjes nëpër markete/dyqane (është gati 50-60 lek/kg) është një tjetër demotivim për këtë sektor. Puna e pamjaftueshme mobilizuese, organizuese (mungesa e grupimeve dhe shoqatave formale dhe apo informale si dhe fobia ndaj tyre) kanë ndikuar në uljen e interesit për këtë bimë, etj.;

<sup>8</sup> Parcela pyjore me gështenja natyrore

#### 4.9.3 Pengesat dhe vështirësitë kryesore në aspektet e përpunimit

*Nga vrojtimet e bëra dhe informacioni i grumbulluar, rezulton se ekzistojnë një sërë vështirësish dhe më kryesoret janë:*

- Teknologjia është thujse artizanale (e thjeshtë), dhe ajo që është më e evidente është fakti se linjat e përpunimit janë me kapacitete të kufizuara për përpunimin e frutave në nënprodukte, si: miell, brum, të thata, etj.
- Mungojnë kapacitetet e nevojshme teknike për të realizuar në kohë dhe cilësi proceset e larjes, kalibrimit dhe tharjes. Për pasojë, mundësia e grumbullimit në pikun e prodhimit të këtyre produkteve dhe ajo e ruajtjes është e ulët.
- Mungojnë mjetet dhe pajisjet e duhura për të bërë zhveshjen në cilësinë e duhur të produkteve, paketimin e tyre sipas standardeve të kërkuara ndërkombëtare.
- Probleme për transportin e produkteve dhe eksportimin e tyre në destinacion, rruga e gjatë dhe e pamundur nga Tropoja për në Qafë të Malit (sepse me anë të tragetit në Liqenin e Komanit është e pamundur për arsye të madhësisë së rimorkiove). Gjithashtu, mundësia e kalimit për në Kosovë dhe më pas në portin e Durrësit, e vështirëson jashtëzakonisht shumë këtë procedurë.
- Grumbulluesit lokal të cilët realizojnë grumbullimin e frutave nga fermat dhe me pas e transportojnë atë për në pikën e përpunimit, nuk kanë kushte të përshtatshme ruajtjeje dhe për pasojë cilësia e frutave vjen e dëmtuar, me temperaturë të lartë dhe/ose nën cilësinë e duhur.
- Mjetet e transportit nga pikat e grumbullimit për në njësinë e përpunimit. Zakonisht janë kamionë që përdoren për transporte të ndryshme dhe nuk janë të përshtatshme për transportim gështenjave..

#### 4.9.4 Ecuria e bizneseve të bimëve mjekësore gjatë viteve të fundit

Gjatë 3 viteve të fundit, sipas të dhënave rezulton se bizneset kanë rritur në 30 % punën dhe të ardhurat. Për rrjedhojë kanë bërë edhe investime në ndërtimin e depove dhe rritjen e kapaciteteve

Për pjesën e Shqipërisë dhe Kosovës, është një potencial i madh i bimëve mjekësore dhe frutave të malit, të pa shfrytëzuara. Sipas specialistëve të pyjeve, vetëm 60 % e kapacitetit të bimëve mjekësore dhe frutave të malit shfrytëzohet. Për më tepër janë me mijëra hektarë tokë bujqësore e pakultivuar, disponibël, që mund të mbillet me bimë mjekësore dhe aromatike.

Sipas INSTAT eksporti i bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit gjatë 3 viteve të fundit është rritur mbi 30 %. Edhe intervistat e zhvilluara me grumbulluesit e këtyre bimëve e konfirmojnë këtë fakt. Të gjithë pa përjashtim theksojnë se ky sektor është një potencial shumë i madh punësimi dhe të ardhurash sidomos për familjet në nevojë.

Po kështu këtë sektor e ndihmojnë edhe krahu ilirë i punës, sidomos i grave dhe të rinjve. Vendndodhja e banimeve afër zonave me bimë mjekësore dhe fruta mali ka krijuar lehtësira në mbledhjen e produkteve. Një pikë e fortë tjetër është se familjet e varfra kanë shumë anëtarë dhe vjelja e bimëve mjekësore përkon me periudhën kur nxënësit e shkollave dhe studentët kanë mbaruar periudhën e vitit shkollor.

## 5. KOSOVA

**K**osova ka një sipërfaqe prej rreth 1.1 milionë hektarësh. Nga kjo hapësire, rreth 50 për qind klasifikohet si tokë bujqësore, 44 për qind është tokë pyjore dhe pjesa e mbetur prej 6 për qind, definohet si tokë për shfrytëzime të tjera. Nga rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Kosova ka gjithsej 1, 739 825 banorë, pa përfshirë popullsinë që banon në Komunën e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut (ASK, 2013). Të njëjtat të dhëna tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale (62%), ndërsa 38% jetojnë në zonat urbane.

Një total prej 180 800 ha (38%) të pyjeve të Kosovës klasifikohet si pyje në pronësi private dhe 295 200 ha (62%) klasifikohet si pyje shtetërore. Kosova ka të miratuar Ligjin për Pyje (2004), e cila përbën bazën ligjore që definojnë pyjet si resurse kombëtare, të cilat duhet të menaxhohen për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

Ligji i Kosovës për Pyje (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 2004), përbën bazën ligjore që përcakton pyjet si resurse kombëtare, të cilat duhet të menaxhohen për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve, si burim me interesim të përgjithshëm.

Sipas të gjeturave nga raporti i inventarizimit kombëtar të pyjeve në Kosovë (Tomter dhe të tjerë, 2013), vendi ka një sipërfaqe të përgjithshme pyjore prej 481 000 ha. Pyjet kryesisht dominohen me drurë gjetherënës, të cilët mbulojnë 93 për qind të tokës së përgjithshme pyjore dhe drurë halorë, të cilët mbulojnë pothuajse 5 për qind. Duke marrë parasysh faktin se 44 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të vendit mbulohet me pyje, të cilat karakterizohen me produktivitet dhe shumëllojshmëri të madhe, të gjitha studimet përkatëse tregojnë që nëse këto burime menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme, sektori pyjor, e në veçanti produktet pyjore jo-drusore, duke përfshirë frutat e malit dhe bimët mjekësore, do të mund të sigurojnë më shumë mundësi punësimi, veçanërisht për banorët e viseve rurale.

Në raportin Promovimi i Hortikulturës në Kosovë (Boor, 2011), Kosova ka potencial të mbledhjes së më së paku 29,000 ton të produkteve pyjore jo-drusore, duke përfshirë 85 specie me potencial ekonomik të lartë, të tillë si rigon, mente, primula veris, manaferrat, kaçat, kamomili, trumza etj. Sipas po të njëjtit raport, në Kosovë janë rreth 11,400 grumbullues, 100 kultivues, 40 qendra grumbulluese dhe 10 përpunues aktiv në këtë veprimtari.

Sipas raportit të inventarizimit të bimëve mjekësore aromatike në Kosovë (Millaku, 2010) më të kërkuara për eksport janë: boronica, dëllinja, agulicja, mështekna, shtogu, molla e egër, murrizi, thana, lule basami, bar pezmi, hithra, listra, trëndafili i egër.



## 5.1 Profilet e komunave

Në këtë pjesë të raportit do të ofrohen informacione të shkurtra për secilën komunë (OSCE Municipal Profile, 2018), që janë pjesë e këtij hulumtimi.

### 5.1.1 Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit është e vendosur në Kosovën juglindore. Ajo mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 640 km<sup>2</sup> dhe përfshin qytetin e Prizrenit dhe 74 fshatra. Sipas të dhënave për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, popullsia e përgjithshme është 177,781 banorë. Klima e Prizrenit ka karakter kontinental me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare në lartësitë më të ulëta, ndërsa në male dominon klima e ashpër alpine. Karakteristikat e buta klimatike janë arsye e resurseve të pasura natyrore. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit dhe frutave e perimeve tjera. Pyjet në Prizren kanë sipërfaqe prej 8,500 ha ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët që janë vetëm 13 % e komunës (Profili Komunal i Prizrenit, 2007).

Ekonomia e komunës së Prizrenit kryesisht bazohet në bujqësi, tregti, ndërtim dhe përpunim të ushqimit, të gjitha private. Janë rreth 5.400 biznese private të regjistruara që veprojnë në komunë. Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e personave të punësuar në sektorin privat.

### 5.1.2 Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit gjendet në jug të Kosovës. Ajo mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 435 km<sup>2</sup> dhe përfshin qytetin e Dragashit dhe 35 fshatra. Sipas të dhënave për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, popullsia e përgjithshme është 33,997 banorë. Ekonomia e komunës së Dragashit është kryesisht bazuar në bujqësi dhe biznese të vogla. Janë rreth 744 biznese private të regjistruara që veprojnë në komuna me rreth 1,152 punonjës. Kjo komunë ka një lartësi relativisht të madhe mbidetare, që sillet prej 700-2550 metra mbi nivelin e detit, gjë që bën që dimrat në këtë komunë të jenë të gjatë kurse verat të shkurta dhe të freskëta.

Me pak mundësi ekonomike, papunësia është e lartë, duke rezultuar në një migrim të konsiderueshëm nga zona. Megjithatë, ajo është e pasur me burime natyrore, me zona malore, pyje të mëdha dhe tokë pjellore bujqësore. Fermerët e rajonit të Dragashit janë të njohur mire për prodhimin e qumështit, duke përfshirë shumë lloje të djathërave, koleksion e mjedrave dhe produkteve të tjera pyjore jo drusore është gjithashtu e zakonshme. Është ndër rajonet më dendësisht të banuara dhe më të varfra të Kosovës. Vlerësohet se rreth gjysma e popullsisë është nën 30 vjeç (ASK, 2011).

### 5.1.3 Komuna e Mamushës

Komuna e Mamushës gjendet në Kosovën juglindore dhe mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 11 km<sup>2</sup>. Sipas të dhënave për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, popullsia e përgjithshme është 5,507 banorë. Ekonomia e komunës së Mamushës është e bazuar kryesisht në bujqësi dhe aktivitete tregtare. Janë rreth 800 biznese private të regjistruara që veprojnë në komunë. Nuk ka të dhëna të sigurta për numrin e njerëzve të punësuar në sektorin privat.



#### 5.1.4 Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës gjendet në Kosovën juglindore. Ajo mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 361 km<sup>2</sup> dhe përfshin qytetin e Suharekës dhe 42 fshatra. Sipas të dhënave për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, popullsia e përgjithshme është 59,722 banorë. Nga sipërfaqja totale e komunës, 15.074 ha ose 41.7 % janë të mbuluara me pyje, 19.373 ha ose 53.7 % janë tokë bujqësore dhe 1.652 ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër (Profili Komunal i Suharekës, 2005).

Ekonomia e komunës së Suharekës është kryesisht në gomë, veshjeve dhe pijeve, alkoolike dhe jo-alkoolike, prodhimin dhe tregti të vogël. Ka rreth 3,700 biznese të regjistruara, nga të cilat rreth 2,316 biznese janë aktive ndërsa pjesa tjetër konsiderohet joaktive. Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e njerëzve të punësuar në sektorin privat.

#### 5.1.5 Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit gjendet në Kosovën jugperëndimore. Ajo mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 275 km<sup>2</sup> dhe përfshin qytetin e Rahovecit dhe 35 fshatrat. Sipas të dhënave për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, numri i përgjithshëm i popullsisë është 56,208 banorë.

Komuna e Rahovecit njihet si lokalitet bujqësor. Kjo komunë vlerësohet për cilësinë e rrushit dhe verërave që prodhon. Ekonomia e komunës së Rahovecit kryesisht bazohet në bujqësi, veçanërisht vreshtari dhe prodhim të plastikës, ngrohje, ngrirësve dhe riciklim. Ka rreth 1,120 biznese të regjistruara private që veprojnë në komunë. Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e njerëzve të punësuar në sektorin privat.

#### 5.1.6 Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës është e vendosur në Kosovën juglindore. Ajo mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 306 km<sup>2</sup> dhe përfshin Malishevën dhe 43 fshatra. Sipas të dhënave për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, numri i përgjithshëm i popullsisë është 54,613 banorë. Ekonomia e komunës së Malishevës bazohet kryesisht në bujqësi dhe bizneseve të vogla shitjeje. Janë rreth 1,434 biznese private të regjistruara që veprojnë në komunë.

### 5.2 Të gjeturat e hulumtimit

Informatat e dhëna në këtë seksion japin një pasqyrë të përgjithshme për sfidat dhe nevojat e punëdhënësve që merrem me veprimtarinë e grumbullimit, përpunimit, kultivimit dhe shitjes së frutave të malit dhe bimëve mjekësore.

Të dhënat nga intervistat e realizuara tregojnë se në rajonin e përzgjedhur për hulumtim janë identifikuar gjithsejtë 9 biznese që merren me këtë veprimtari. Në shtojcën B gjendet lista e grumbulluesve të Kosovës, bashkë me detajet se çfarë mbledhin dhe ku e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bashkë me informatat e tjera identifikuese.

Pjesa më e madhe e bizneseve të identifikuara në këto komuna janë relativisht stabile financiarisht, sidomos ato që janë në treg për një kohë më të gjatë. Dy nga numri total i bizneseve realizojnë eksport direkt në vendet evropiane ndërsa pjesa tjetër shesin produktet tek eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë. Vetëm një nga bizneset e identifikuara ka synim primar tregun vendor dhe në periudhën afatmesme nuk planifikon të bëjë eksport të produkteve. Përveç bizneseve të rajonit të Dragashit, produktet e të cilëve mbledhen direkt në pyje, shumica e bizneseve tjera merren me kultivim të frutave të malit dhe bimëve mjekësore në tokat bujqësore, të cilat i plotësojnë kushtet organike për të zhvilluar një veprimtari të tillë.

Të intervistuarit në rajonin e Dragashit kryesisht bëjnë grumbullimin, tharjen, përpunimin dhe shitjen e kaçës, hithrës, alkemilës, blirit, mështeknës, lule balsamit, kamomilës, luleshtrydhes mjekësore, mollës së egër, boronicës, shtogut, aguliçes.

Hulumtimet e ndryshme tregojnë se ky rajon është i pasur me fruta të malit dhe bimë mjekësore, dhe ndër produktet më të kërkuara për eksport janë: dëllinja, aguliçja, shtogu, boronica, thana, murrizi, lule basami, bar pezmi, hithra, listra, molla e egër, blini, manaferra, mjedra dhe lloje të ndryshme të kërpudhave.

**TABELA 4.** Bizneset e identifikuara, veprimtaria, nevojat dhe sfidat

Vendi	Veprimtaria	Sfidat dhe nevojat
<b>Prizren</b>	Grumbullim, tharje, përpunim dhe paketim (për eksport) të frutave të malit dhe bimëve mjekësore. Biznesi po ashtu bën edhe kultivimin e manaferrave. Biznesi bën shitjen e produkteve tek Agroproduct, Istog.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konkurrencë e pabarabartë në treg;</li> <li>• Ndryshim i paparashikuar i çmimeve të produkteve;</li> <li>• Mungesë e përkrahjes institucionale;</li> <li>• Mungesë e interesimit të të rinjve për të punuar në këtë sektor;</li> <li>• Nevoja për rrjetëzim me biznese të Kosovës por edhe rajonit;</li> <li>• Lehtësira administrative për bizneset që kanë synim eksportin;</li> <li>• Nevoja për pajisje shtesë për ruajtje dhe përpunim të produkteve.</li> </ul>
<b>Dragash</b>	Grumbullim, përpunim dhe eksport të frutave të malit dhe bimëve mjekësore. Dy nga bizneset e identifikuara bëjnë vet eksportin e produkteve, ndërsa dy të tjerë shesin ato tek eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka punëtorë/të rinj të mjaftueshëm për të punuar, sidomos në plantacione.</li> <li>• Përfshirja e grave në këtë veprimtari tepër e ulët.</li> <li>• Interesi bankarë tepër i lartë</li> <li>• Probleme me mbledhësit nga Shqipëria: cilësia e dobët e produkteve, vjelja para kohe e produkteve.</li> <li>• Mungesë e përkrahjes institucionale;</li> <li>• Mungesë të hapësirës; depove dhe magazinave për ruajtjen e mallit (karakteristike për bizneset e reja)</li> <li>• Rezultatet e analizave të produkteve (në laboratorin për analiza bujqësore në Pejë) nganjëherë vonohen;</li> <li>• Nevojë për t'u trajnuar për procedurat e ndryshme doganore;</li> <li>• Nevoja për pajisje shtesë për ruajtje dhe përpunim të produkteve.</li> </ul>

<p><b>Suharekë</b></p>	<p>Përpunim, kultivim, paketim dhe shitje të çajeve si: kamomil, xhenxhefil, sherbelë, lule shtog, brusnicë dhe boronicë. Biznesi ka target tregun vendor.</p> <p>Bën grumbullimin, përpunimin dhe shitjen e produkteve të bimëve të përpunuara.</p> <p>Biznesi bën shitjen e produkteve tek Agroproduct, Istog.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë të punëtorëve të trajnuar në vjelje dhe proces të përpunimit;</li> <li>• Mungesë e interesimit të rinjve për të punuar në këtë sektor;</li> <li>• Mungesa e përkrahjes institucionale;</li> <li>• Nevoja për rrjetëzim me biznese të Kosovës por edhe rajonit;</li> <li>• Lehtësira administrative për bizneset që kanë synim eksportin;</li> <li>• Nevoja për pajisje shtesë për ruajtje dhe përpunim të produkteve.</li> </ul>
<p><b>Malishevë</b></p>	<p>Biznesi bën grumbullimin, përpunimin dhe kultivimin e bimëve aromatike dhe bën prodhimin e fidanëve organike. Nga 2014 biznesi ka filluar me kultivimin e bimëve mjekuese.</p> <p>Biznesi bën shitjen e produkteve tek Agroproduct, Istog.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcjellje / përkrahje të bizneseve deri sa të bëhen të qëndrueshme financiarisht;</li> <li>• Procedura të ndërlikuara të eksportit, administratë dhe shpenzime shtesë për përgatitje të dokumenteve;</li> <li>• Tatim i lartë (18% për produkte);</li> <li>• Nevojë për puse (sistem të ujitjes) për fermerët që merren me kultivimin e këtyre produkteve;</li> <li>• Trajnime të stafit për lidhje kontraktuale;</li> <li>• Ndihmë në reklamim dhe promovim të produkteve dhe vlerës së shtuar bio të tyre;</li> <li>• Lehtësim i pjesëmarrjes së bizneseve në panaire</li> <li>• Përkrahje në realizimin e vizitave studimore në Shqipëri/Kosovë</li> <li>• Nevoja për pajisje shtesë për ruajtje dhe përpunim të produkteve.</li> </ul>
<p><b>Rahovec</b></p>	<p>Grumbullim, kultivim, terje dhe shitje të çajeve dhe bimëve mjekuese.</p> <p>Biznesi bën shitjen e produkteve tek Agroproduct, Istog.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i cilësisë së produkteve – standarde shumë të larta të cilat duhet të përmbushen;</li> <li>• Investimet shumë të larta vetanake në fillim të zhvillimit të biznesit;</li> <li>• Kredi bankare jo lehtësuese për bizneset e këtij sektori;</li> <li>• Nevojë për ngritje të bashkëpunimit në mes të fermerëve;</li> <li>• Mungesa e përvojës në kultivim;</li> <li>• Nevojë për trajnime në fushën e bio-certifikimit;</li> </ul>
<p><b>Rahovec</b></p>	<p>Grumbullim, kultivim, terje dhe shitje të çajeve dhe bimëve mjekuese.</p> <p>Biznesi bën shitjen e produkteve tek Agroproduct, Istog.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i cilësisë së produkteve – standarde shumë të larta të cilat duhet të përmbushen;</li> <li>• Investimet shumë të larta vetanake në fillim të zhvillimit të biznesit;</li> <li>• Kredi bankare jo lehtësuese për bizneset e këtij sektori;</li> <li>• Nevojë për ngritje të bashkëpunimit në mes të fermerëve;</li> <li>• Mungesa e përvojës në kultivim;</li> <li>• Nevojë për trajnime në fushën e bio-certifikimit;</li> </ul>

**Sqarim:** Shumica e bizneseve të identifikuar kanë pothuajse të njëjtat sfida dhe nevoja; varësisht nga niveli i zhvillimit dhe kohëzgjatja e prezencës së tyre në treg. Sidoqoftë, tabela ka për qëllim të ofrojë informata që janë më tipike/karakteristike për bizneset e caktuara. Kjo nuk do të thotë se nevojat e identifikuar në një komunë janë jo prezente në bizneset e komunës tjetër. Më shumë informata lidhur me sfidat dhe nevojat e punëdhënësve, janë të prezantuara në pjesën e më poshtme të raportit.

### 5.2.1 Potenciali i zhvillimit të këtij sektori

Sipas hulumtimeve të zhvilluara për këtë veprimtari, grumbullimi i frutave të malit dhe bimëve mjekësore në vitet e fundit ka qenë spontan, jo-mirë i organizuar dhe është karakterizuar me mungesë kontrolli dhe monitorimi nga institucionet vendore përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve (Millaku, 2010). Po i njëjti raport tregon se kjo ka shkaktuar dëmtime dhe zvogëlim të fondit kryesisht të bimëve mjekësore aromatike, të tillë si *Gentiana lutea* dhe *Gentiana punctata*, të cilat konsiderohen se janë në rrezik të zhdukjes.

Në përgjithësi, bizneset e identifikuar kanë infrastrukturën dhe mjetet e duhura për të tharë, ftohur apo mirëmbajtur produktet e grumbulluara, varësisht prej kapaciteteve të tyre. Rajoni ku janë zhvilluar intervistat me punëdhënësit, është shumë i pasur me fruta të malit dhe bimë mjekësore. Hulumtimi konfirmon edhe njëherë se për shumë banorë të zonave rurale që shtrihen afër rajoneve të pasura me bimë mjekësore dhe fruta të malit kjo veprimtari paraqet një burim të ardhurash shtesë, madje edhe të ardhurave të vetme.

Bizneset përgjatë viteve kanë rritur cilësinë e produkteve të grumbulluara, kanë përmirësuar metodat e monitorimit të punës së grumbulluesve, të tillë si kodimi i mbledhësve në mënyrë që të shmangen problemet me cilësinë e produkteve. Sipas përfaqësuesve të biznesit, viteve të fundit ka një rritje të sasisë së mbledhjes së produkteve pasi që është rritur kërkesa në tregun ndërkombëtar dhe po ashtu është shtuar kërkesa për certifikim organik të produkteve. Për më shumë, bizneset kanë përmirësuar kapacitetet e tyre administrative dhe logjistike.

Bizneset (varësisht nga aktiviteti) kanë tharëse, frigoriferë, mjete të transportit për zonat më të largëta. Shumica e tyre janë mbështetur nga donatorët me ngritjen e kapaciteteve. Në përgjithësi, investimet më të mëdha i kanë bërë me vet-financim, dhe kjo në fillim të krijimit të biznesit. Kjo ka qenë shumë e vështirë për pjesën më të madhe të bizneseve, duke marrë parasysh normat e larta të interesit të bankave komerciale në Kosovë, përkrahjen jo të mjaftueshme nga institucionet shtetërore; qendrore dhe ato lokale.

Nga 9 biznese, 2 prej tyre realizojnë eksport, ndërsa 6 të tjera shesin produktet e tyre për eksport përmes kompanisë Agroprodukt në Istog. Vetëm një nga bizneset e intervistuar ka target tregun vendor (kultivim, tharje dhe paketim të çajeve) dhe nuk shfaq interesim për eksport.

Të gjitha raportet e kësaj fushe konfirmojnë se sektori i BM dhe FM në Kosovë si i tërë është zhvilluar në mënyrë të jashtëzakonshme. dhe ka ndryshuar në të struktura. Bizneset më të mëdha kanë ndërmarrë investime të larta në vitet e kaluara. Disa mund të jenë shtyrë nga projektet zhvillimore që ju ka ofruar bashkëfinancim përmes ofrimit të pajisjeve dhe mund të ndjehen në presion për shkak të normave të larta të interesit që duhet të paguajnë për bankat. Përveç bizneseve që tashmë bëjnë direkt eksportimin e produkteve, pjesa më e madhe e tyre kanë vështirësi në krijimin e kontakteve me bizneset e kësaj natyre në rajon, apo edhe rrjetëzimin me biznese të BE-së që mund të blejnë produktet e tyre.

Mbledhja e këtyre produkteve konsiderohet si një gjenerues i të ardhurave për shumë familje në të cilën janë përfshirë të gjithë anëtarët e familjes. Megjithatë, nuk ka një numër të saktë të banorëve, sidomos grave dhe fëmijëve që janë të përfshirë në këto aktivitete, pasi që në shumicën e rasteve angazhohen të gjithë anëtarët e familjes për grumbullim të produkteve. Shumicës së mbledhësve i mungon edukimi përkatës, sidomos për aktivitetet e pas-vjeljes, që është një prej arsyeve pse cilësia e produkteve të mbledhura shpesh rrezikohet dhe si pasojë edhe dëmtimin e bizneseve në fjalë.

### **5.2.2 Punësimi në sektorin e grumbullimit dhe përpunimit të BM dhe FM**

Nga të dhënat e gjeneruara nga nëntë bizneset e intervistuar, numri i punëtorëve me orar të plotë përgjatë 12 muajve sillet nga 3 deri në 20. Në përgjithësi sektori funksionon përgjatë muajve ku edhe ka produktivitet të madh të produkteve, e që janë muajt Maj-Nëntor. Kjo është periudha kur bizneset punësojnë numër më të madh të punëtorëve, të cilët kryesisht vendosen në të ashtuquajturat plantacione, dhe numri i punëtorëve sezonal sillet nga 10 deri në 70.

Bizneset e intervistuar kanë kontrata shërbimi me një numër të madh të familjeve dhe ky numër sillet nga 40 deri në 150 familje që angazhohen gjatë periudhës Maj-Nëntor për të grumbulluar fruta të malit dhe bimë mjekësore apo edhe familjet të cilat kultivojnë këto produkte, duke respektuar standardet bio-organike.

Sipas shumicës së të intervistuarve, të hyrat për familjet grumbulluese dhe kultivuese përgjatë sezonit sillen nga 7,000 deri në 10,000 euro; varësisht nga angazhimi i tyre dhe disponueshmëria e produkteve të caktuara në teren.

Edhe pse ka informata për numrin e përafërt të familjeve që merren me këtë veprimtari, nuk është e qartë nëse familje të njëjta grumbullojnë produkte për biznese të ndryshme.

## **5.3 Sfidat dhe nevojat në zhvillimin e biznesit**

### **5.3.1 Kushtet e zhvillimit të biznesit**

Një pjesë e sfidave të bizneseve të identifikuar lidhen me kushtet dhe ambientin e të bërit biznes në Kosovë. Normat e larta të interesit nga ana e bankave komerciale është paraqitur si problem tek të gjithë bizneset e intervistuar. Mungesa e marketingut dhe aktiviteteve promovuese të produkteve dhe bizneseve të tyre është parë si sfidë në zgjerimin e tregut në këtë veprimtari, e sidomos për bizneset që kanë synim të zgjerojnë shtrirjen e tyre në tregun vendor. Zakonisht produktet promovohen vetëm gjatë panairëve të ndryshme për shitje në tregjet lokale.

Mungesa e një konkurrencë të barabartë të zhvillimit të biznesit mbetet një prej sfidave të punëdhënësve në këtë sektor. Mungesa e mekanizmave të monitorimit e cila do të sigurojë një praktikë të qëndrueshme të mbledhjes së këtyre produkteve, pajisja me licencë të grumbulluesve aktiv në treg jo vetëm do të luftonte informalitetin në këtë sektor por gjithashtu do të siguronte qëndrueshmërinë afatgjatë të këtyre produkteve.

### 5.3.2 Resurset njerëzore

Shumica e përfaqësuesve të bizneseve shprehin brengën për mungesën e interesimit nga të rinjtë për të punuar në këtë veprimtari, gjatë sezonës, sidomos në plantacione. Përfshirja e grave është po ashtu tepër e vogël.

Bizneset kanë nevojë për staf të trajnuar për mbledhje, kultivim dhe përpunimin të FM dhe BM, e po ashtu për staf tjetër profesional, si menaxherë/e apo kontabilist. Nevoja për bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale në komunat përkatëse është parë si tepër e nevojshme. Kjo përfshin edhe vetëdijesimin por edhe trajnimin e grumbulluesve në njohjen e produkteve, kohën e vjeljes së produkteve dhe tharjen adekuate të tyre, duke marrë parasysh standardet e cilësisë. Kjo përfshin edhe mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e frutave të malit dhe bimëve mjekësore.

### 5.3.3 Vendet dhe pajisjet për mbajtjen dhe ruajtjen e produkteve

Bizneset e vogla posaçërisht kanë sfida në sigurimin e vendeve të mbajtjes së produkteve, tharjen dhe mirëmbajtjen adekuate të tyre, të tillë si depo/magazinë.

Pajisjet për tharje dhe ruajtje adekuate të produkteve është parë si një nevojë e madhe e bizneseve. Edhe pse shumica e tyre kanë investuar me mjete vetanake për blerjen e këtyre pajisjeve apo kanë përfituruar pajisje përmes granteve, posedimi i pajisjeve për produkte të caktuara, të cilat në shumicën e rasteve janë shumë të shtrenjta mbetet një sfidë për bizneset të cilat duan të zhvillojnë veprimtarinë e tyre me produkte të reja.

Nevojë për ndihmë në blerje të pajisjeve kanë sidomos bizneset e reja, të cilët shpesh në mungesë kolaterali nuk mund të marrin kredi në bankat komerciale.

### 5.3.4 Cilësia e produkteve të vjela

Problem i veçantë në sigurimin e cilësisë së produkteve, sidomos për bizneset eksportuese është cilësia e tyre. Në këtë drejtim, ankesat kryesore janë se produktet e mbledhura nga grumbulluesit individual nuk janë të gatshme për vjelje dhe shpesh përmbajnë edhe mbetje, në mënyrë që të peshojnë më shumë me rastin e shitjes. Kjo është një sfidë e bizneseve, sidomos të rajonit kufitar me Shqipërinë dhe karakterizon më shumë grumbulluesit e këtyre produkteve që vijnë nga Shqipëria. Kodimi i grumbulluesve ka ndikuar që kjo problematikë të adresohet në mënyrë më adekuate, sidocoftë, vazhdon të mbetet një prej sfidave.

### 5.3.5 Rrjetëzimi dhe krijimi i lidhjeve të reja biznesore

Përderisa bizneset më të mëdha dhe tashmë të qëndrueshme ekonomikisht nuk e kanë këtë problem, për bizneset më të vogla dhe të sapoformuara sfida është krijimi i raporteve të reja biznesore me bizneset në vend dhe ato të rajonit, rrjetëzimi dhe trajnimet e stafit për të pasur një depërtim më të shpejt dhe të qëndrueshëm të këtyre bizneseve në treg. Për më shumë ata kanë nevojë që të ju ndihmohet në pjesëmarrje në panaire të ndryshme, ku ata mund të ekspozojnë



produktet e tyre. Shumë prej tyre theksojnë se organizatat donatore kanë qenë të vetmet që ju kanë ndihmuar të ngritin biznesin e tyre, qofte përmes trajnimeve, dhurimit të pajisjeve apo edhe lehtësimin në krijimin e kontakteve me tregjet e shitjes së produkteve brenda dhe jashtë vendit. Përfaqësuesit e bizneseve si sfidë në vete e kanë prezantuar edhe mungesën e shkëmbimit të informacioneve në mes bizneseve të kësaj veprimtarie, e sidomos atyre të të njëjtit rajon.

### **5.3.6 Mungesa e informacioneve lidhur me tregun - eksporti**

Shumica e bizneseve të intervistuar theksojnë se procedurat dhe udhëzimet doganore janë mjaft të kuptueshme për t'u ndjekur nga ana e bizneseve. Sidoqoftë, bizneset të cilat duan të fillojnë eksportin kanë nevojë të mësojnë për procedurat dhe rregullat doganore dhe po ashtu që për ndryshimet në procedurat doganore, të njoftohen me kohë.

Zakonisht bizneset angazhojnë familje të rajonit të caktuar për të bërë mbledhjen e produkteve. Kryesisht ky bashkëpunim realizohet përmes kontratave me familjet grumbulluese dhe pagesa kryhet në kesh, ditën e njëjtë që produkti dorëzohet. Në rast të dështimit të shitjes së mëtutjeshme të produktit, bizneset (jo-eksportuese) mund të rrezikojnë që produktet e tyre të prishen nëse nuk shiten tek eksportuesit në një kohë relativisht të shkurtër dhe varësisht nga lloji i produktit.

### **5.3.7 Prezencë e ulët në tregun vendor**

Shumica e të intervistuarve nuk kanë ndonjë strategji për rritjen e vizibilitetit të produkteve në tregun e Kosovës. Përveç një biznesi në Bllacë të Suharekës që ka konsumatorë në tregun vendor dhe ka synim afatgjatë këtë treg, pjesa tjetër synim kryesor e kanë eksportin. Kjo direkt ndikon në ndërgjegjësimin e ulët për këto produkte në tregun Kosovar dhe importin e produkteve të njëjta (të cilat eksportohen), por me çmim edhe më të lartë për konsumatorin vendor.

### **5.3.8 Vetëdijesimi i popullatës për rëndësinë e pyjeve si burim të të ardhurave**

Të gjithë të intervistuarit theksojnë rëndësinë dhe domosdoshmërinë që të bëhet vetëdijesimi dhe informimi në kohë dhe gjithëpërfshirës i popullatës mbi rolin, rëndësinë dhe përfitimin që vijnë nga produktet pyjore jo-drusore, si frutat e malit dhe bimët mjekësore. Kjo është parë si tepër e rëndësishme sidomos për familjet që jetojnë shumë pranë pyjeve dhe për të cilët kjo veprimtari do të mund të siguronte të ardhura optimale për një familje.

Të gjitha bizneset e identifikuar konfirmojnë potencialin që ka rajoni për të zhvilluar këtë veprimtari. Mirëpo, përkundër sfidave të përmendura më lartë, të listuara janë edhe ato që lidhen me resurset njerëzore. Një pjesë e tyre kanë vështirësi në rekrutimin e punëtorëve sezonal, pasi që interesimi i popullatës, sidomos të rinjve dhe grave është shumë i vogël. Sipas njërit nga përfaqësuesit e biznesit në Dragash “kërkesa në treg ndërkombëtarë për këto produkte është e sigurt dhe ka rritje për çdo vit, por kam frikë se në të ardhmen e afërt nuk do të ketë të rinj të interesuar të bëjnë grumbullimin e këtyre produkteve”. Për këtë arsye, vetëdijesimi dhe informimi i popullatës lidhur me rolin, rëndësinë dhe përfitimet që mund të vijnë nga këto produkte është parë si kyç në qëndrueshmërinë e kësaj veprimtarie në rajonin përkatës.

Edhe hulumtimet e tjera kanë konfirmuar mungesën e interesimit për grumbullim në sektorin e barishteve (UNDP, 2016). Sipas po të njëjtit raport, popullsia nuk shpreh interesim në mbledhjen e barishteve, kryesisht si rrjedhojë e mungesës së kapaciteteve të pas vjeljes, sikurse janë: tharja dhe magazinimi dhe se pjesëmarrja e popullsisë në këtë sektor ka shënuar rënie në vite.



## 6. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET (E PËRBASHKËTA PËR DY VENDET)

---

**B**imët mjekësore dhe frutat e malit vlerësohen si një burim i rëndësishëm natyror për zhvillimin e zonave rurale. Ky potencial duhet monitoruar dhe vlerësuar nga ekspertë e studiues në mënyrë që të sigurohet një shfrytëzim i qëndrueshëm i tyre. Nga monitorimi i vazhdueshëm do të përcaktohet potenciali për shfrytëzim si dhe do të evidentohen produktet që janë në rrezik zhdukje. Luftimi i informalitetit të çmimeve është një çështje komplekse por shumë e rëndësishme për popullsinë dhe biznesin e angazhuar në këtë sektor. Për këtë arsye duhet të bëhet standardizimi dhe publikimi i çmimeve të shitjes së këtyre produkteve.

Ndonëse vitet e fundit qeveritë e dy vendeve kanë treguar gatishmëri në zhvillimin e kësaj industrie në nivel vendi nëpërmjet dhënies së subvencioneve bizneseve që merren me grumbullim dhe kultivim të këtyre produkteve, sërish kërkohet mbështetje për përmirësimin e teknologjisë përpunuese të tyre, por edhe ruajtëse. Ndërgjegjësimi i fermerëve mbi standardet e grumbullimit të këtyre produkteve në mënyrë që ato të jenë të pastra dhe pa përzierje të tjera është një tjetër rekomandim që del nga ky studim. Kjo do të çonte në rritjen e standardizimit dhe cilësisë së produkteve që rriten në Shqipëri dhe Kosovë. Arritja e këtyre standardeve dhe cilësisë së produkteve të grumbulluara do të çonte natyrshëm dhe në rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë me vendet e rajonit. Për këtë arsyeje është e nevojshme zhvillimi i aktiviteteve avokuese me popullsinë rurale që merren me aktivitetin e mbledhjes së produkteve mbi teknikat e vjeljes, grumbullimit dhe tharjes së tyre.

Raporti konfirmon se grumbulluesit e frutave të malit dhe bimëve mjekësore janë kryesisht familjarë, të cilët jetojnë afër pyjeve ku mblidhen këto produkte, specifike kjo e rajonit të Dragashit dhe rajoneve të Shqipërisë. Për komunat tjera është më specifike kultivimi i frutave të malit dhe bimëve mjekësore në tokat punuese, duke iu përmbajtur cilësisë së pastër organike që duhet të ketë toka ku këto produkte kultivohen.

Bizneset përballen me një numër vështirësish dhe sfidash, të tillë si mungesa e kredive bankare të favorshme për të zhvilluar biznesin, mungesa e pajisjeve të cilat sigurojnë por edhe rrisin cilësinë, duke shtuar kështu vlerën në tregun ndërkombëtarë, nevoja për trajnim të grumbulluesve dhe stafit sezonal dhe atyre menaxhues, nevoja për rrjetëzim me bizneset në vend por edhe në rajon etj.

*Për të adresuar të gjitha sfidat dhe nevojat e identifikuara gjatë intervistave me përfaqësues të bizneseve, janë të listuara rekomandimet me të cilat synohet që të adresohen disa nga të gjeturat në raport:*

- 1)** Lehtësimi i të bërit biznes në këtë veprimtari - Përkrahja e bizneseve me grante dhe subvencione nga ana e institucioneve relevante por edhe organizatave zhvillimore, sidomos atyre bizneseve që janë në fillimet e veprimtarisë së tyre.
- 2)** Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore – Personat të cilët merren me mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e FM dhe BM duhet të trajnohen për të njohur produktet që grumbullojnë, mënyrën e vjeljes, proceset e kultivimit dhe aspektet e përpunimit të mëtejme të tyre, kohën dhe procedurat që duhet të zbatojnë përgjatë procesit. Bizneset po ashtu duhet të përkrahen në ngritjen e kapaciteteve menaxheriale, financiare dhe administrative të stafit të angazhuar.
- 3)** Hartimi dhe zhvillimi i një strategjie kombëtare - Kjo do të siguronte një zhvillim të qëndrueshëm dhe administrim adekuat të këtij sektori. Është shumë e nevojshme që të bëhen përmirësime ligjore me qëllim që mbledhja e bimëve mjekësore dhe frutave të malit të bëhet vetëm nga subjektet te licencuara.
- 4)** Nxitja e subjekteve grumbulluese, ndihma e krijimi i lehtësirave për mbjelljen e bimëve mjekësore në vendet e degraduara. Sensibilizimi, tërheqja e nxitja e donatorëve për të investuar në këtë drejtim.
- 5)** Përkrahja e zhvillimit të një strategjie lokale për zhvillimin e sektorit të frutave të malit dhe bimëve mjekësore në pajtim me strategjitë nacionale për zhvillimin e produkteve pyjore jo-drusore. Kjo strategji duhet të përfshijë përfshirjen e të gjithë aktorëve relevant të kësaj fushe.
- 6)** Zhvillimi i një regjistri të të gjithë grumbulluesve në nivel komunal/bashkiak dhe të gjitha aktorëve të tjerë që punojnë në këtë sektor.
- 7)** Të ndihmohet në përmirësimin e marketingut në promovimin e vlerës së shtuar të këtyre produkteve, sidomos në tregun vendor.
- 8)** Të ndihmohet në përmirësimin e kapacitetit të bizneseve dhe atyre që duan të hapin biznes në këtë sektor në procedurat që lidhen me aplikimin në grante dhe subvencione.
- 9)** Të ndihmohen bizneset, sidomos atyre që sapo janë krijuar në procesin e rrjetëzimit, krijimit të lidhjeve të reja biznesore, pjesëmarrja në panairë etj.
- 10)** Të gjithë grumbulluesit e frutave të malit dhe bimëve mjekësore që merren me këtë veprimtari duhet të pajisen me licencë nga ana e institucioneve përkatëse, dhe me këtë rast edhe të caktohet sasia e mbledhje së produkteve. Kjo sasi duhet të caktohet duke mos rrezikuar zhdukjen e produkteve në një periudhë afatgjate.
- 11)** Të ndihmohen bizneset që merren me këtë veprimtari në krijimin e asociacioneve rajonale apo edhe kooperativave, përmes të cilave do të nxitet dhe mundësohet punësimi i të rinjve dhe grave, në veçanti. Kjo mund të përfshijë edhe krijimin e kooperativave/asociacioneve të grumbulluesve të vegjël, të shpërndarë në rajone të caktuara.
- 12)** Ofrimi i ndihmës juridike dhe administrative për bizneset e reja.
- 13)** Promovimi i përfshirjes së grave në këtë veprimtari, bizneseve të udhëhequra nga gratë, sidomos në zonat më të thella rurale, qoftë përmes ofrimit të subvencioneve, granteve apo edhe përpilimit të planeve biznesore për aplikim në grante.
- 14)** Lehtësimi i vizitave studimore i bizneseve nga të dy vendet, me qëllim të mësimin të përvojave të reja, më të ndryshme dhe storjeve të suksesit.

## 7. REFERENCAT

---

- UNDP (2016). Zinxhiri i vlerave të qumështit dhe mishit; pemëve, perimeve dhe drithërave; barishteve; bletëve; frutave të malit; dhe tekstilit e veshmbathjeve. Plani i detajuar i zbatimit me vlerësimet e kostos. Komuna e Dragashit. (Në dispozicion në: <http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Inter%20Dev/Dragash%20Value%20Chains%20Implementation%20Plan%20ALB.pdf>)
- Boor, B. (2011). Horticulture Promotion in Kosovo (2011). Helvetas, Swiss Cooperation. Prishtinë. (Në dispozicion: <http://helvetaskos.org/HPK/documentation/marketing/Market%20studies/HPK%20NĚFP%20Report%20Birgitt%20Boor%202011.pdf>)
- KAS (Agjencia e Statistikave të Kosovës). 2013. Vlerësimi i popullsisë së Kosovës, 2011. Prishtinë. (në dispozicion në <http://ask.rks-gov.net/media/2129/estimationof-kosovo-population-2011.pdf>)
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2004. Ligji Nr. 2003/3 për pyjet në Kosovë. (në dispozicion në [http://www.gazetazyrtare.com/egov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=244&Itemid=28&lang=en](http://www.gazetazyrtare.com/egov/index.php?option=com_content&task=view&id=244&Itemid=28&lang=en)).
- MMPH (2005). Komuna e Suharekës. Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. (Në dispozicion në [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/AH\\_-\\_Suhareke.pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/AH_-_Suhareke.pdf))
- Millaku F. (2012). Inventari – Bimët mjekësore aromatike dhe pemët frutore të egra në Kosovë. (Në dispozicion në: [http://www.helvetas-ks.org/HPK/documentation/technical\\_reports/101007RaportiiinventaritteBMAdhePFE.pdf](http://www.helvetas-ks.org/HPK/documentation/technical_reports/101007RaportiiinventaritteBMAdhePFE.pdf)).
- Tomter, S.M., Bergsaker, E., Muja, I., Dale, T. & Kolstad, J. 2013. “Kosovo National Forest Inventory 2012” (Inventarizimi kombëtar i pyjeve në Kosovë 2012). Prishtinë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë dhe Grupi norvegjez për pylltari. (në dispozicion në <http://www.nfg.no/userfiles/file/kosovo/kosovo%20national%20forest%20inventory%202012.pdf>)
- Voit M., & Barrientos M. (2013). Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013 – 2023. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). (Në dispozicion në: [http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Dragash/mdp/AL\\_MDP%20Part%201%202013-2023%20Dragash%20Final%2026.08.2013.pdf](http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Dragash/mdp/AL_MDP%20Part%201%202013-2023%20Dragash%20Final%2026.08.2013.pdf))
- Qendra e Botimeve Zyrtare ([www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al); [www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)).

Mulaj Z., *880 bimë mjekësore në Alpet e Shqipërisë*, Edloar, Tiranë, 2008.

Bimët mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë, Tiranë 1976, fq.5

Vangjeli J, Ruci B, Mullaj A. Libri i Kuq, Tirane 2007 fq.6

JAK GJINI - Administrimi Bimëve Mjekësore – Jak Gjini, Lezhe 2018.

UNDP Albania – Këshilli Qarkut Kukës Strategjia e Zhvillimit e Qarkut Kukës 2012-2016.

UNDP Albania – Këshilli Qarkut Lezhe Strategjia e Zhvillimit e Qarkut Lezhë 2012 -2016

SNV Programi ProMali, viti 2011, Potencialet natyrore të bimëve aromatike-mjekësore Shqipëri

ARZM Administrata rajonale e zonave të mbrojtura - Kukës 2018

DLDP – Bashkia Kukës: Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës.

DLDP- Bashkia Tropoje : Plani Përgjithshëm Vendor Bashkia Tropojë

DRB - Vjetari Statistikor i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit Kukës

## 8. SHTOJCAA - BIZNESET E SHQIPËRISË

Nr.	Emri i Biznesit	Kontakti	Vendi	Aktiviteti / numri punonjësve	A grumbullon FM (po çfarë/jo)	Ku i shet produktet
<b>Lezhë</b>						
1	UJKA	0692426938 Nikolin Ujka	Balldren, Lezhe	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbele, trumze, zhumbriçë, lisën Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 4 punëtorë sezonal.	Dëllinjë, mollë e egër, kunupicë, kokërr murrizi, shegë e egër, boce pishë	Kryesisht në tregun e brendshëm
2	ÇUPI	0683393726 Prengje Çupi	Ishu II Lezhe	Grumbullon bimë mjekësore : Sherbelë, trumze, lisën, hala pishash, mëllagë, teucrum, balsam, dafinë, etj. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 5 punëtorë sezonal.	Dëllinjë	Jashtë vendit
3	KOLNDREU	Gjeto Kolndreu	Torovicë	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbele, trumze. Ka 1 punëtor me kohë të plotë dhe 3 punëtorë sezonal.	Jo	Treg i brendshëm
4	PALI	0692621637 Ludovik Pali	Balldre	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbele trumza tërfil, etj. Ka 1 punëtor me kohë të plotë dhe 3 punëtorë sezonal	Jo	Treg i brendshëm

5	IVANAJ	0694428300 Enxhell Ivanaj	Ishull Lezhe	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbele, trumze, lisën, zhumbrice. Ka 1 punëtor me kohë të plotë dhe 4 punëtorë sezonal	Jo	Treg i brendshëm
<b>Mirditë</b>						
6	PERSHQEFA	0693192762 Nikoll Pershqefa	Rrëshen Mirdite	Grumbullon bimë mjekësore :Gjethe dell, gjembaç, dafine, balsam, lisën, zhumbrice, mëllagë Ka 1 punëtor me kohë të plotë dhe 4 punëtorë sezonal	Po, boronicë, dëllinjë, (me pakicë)	Treg i brendshëm
7	LIKA	Gjelina Lika	Rrëshen Mirdite	Shumë lloje të bimëve mjekësore të Mirditës. Ka 1 punëtor me kohë të plotë dhe 3 punëtorë sezonal		Treg i brendshëm
<b>Kurbin</b>						
8	Filipi Co	0682021352 (Filip Gjoka)	Gjorm, Kurbin	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbele, të gjitha bimët mjekësore të Shqipërisë së verit Ka 160 punëtorë me kohë të plotë dhe 40 punëtorë sezonal	Të gjitha frutat e egra, si boronicë	Treg i jashtëm, Evropë, Amerikë.

9	BOCI	0685876173 Mark Boci	Mamurras Kurbın	Grumbullon bimë mjekësore : Sherbelë, trumze, lisën, mullagë e bardhë, balsam. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 3 punëtorë sezonal	Jo	Treg i brendshëm
10	AGROHERBAL	Arifi Daci	Mamurras	Grumbullon bimë mjekësore : Shumë bime mjekësore të dyta, si hithra, ferra, balsami, mullagë, teucrum etj. Ka 90 punëtorë me kohë të plotë dhe 30 punëtorë sezonal	Po, të gjitha frutat e egra, si dhe boronicë.	Treg i brendshëm
<b>Kukës</b>						
11	HALLAÇI	0692358705 Shkëlzen Hallaci	Kukës (Z. Industriale)	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbelë, trumzë, dëllinjë e zezë, aguliçe. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 6 punëtorë sezonal	Të gjitha frutat e egra, mollë, trëndafil dhe boronicë	Tregu i brendshëm. Ka licencë per treg te jashtëm
12	TAHIRI	0682019183 Qemal Tahiri	Kukës, Parku i Ri	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbele, trumze, dëllinje e zezë, aguliçe. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 4 punëtorë sezonal	Te gjitha frutat e egra, molle, boronicë, manaferra	Tregu i brendshëm
13	SHEHU	0682290292 Eduart Shehu	Kukës (Nj. A. Bica) )	Grumbullon bimë mjekësore Sherbele, trumze. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 4 punëtorë sezonal	Molle e egër, boronicë, manaferra	Tregu i brendshëm

14	YLBERI	0692796645 Ylber Shehu	Kukës (Nj.A. Bushtricë	Grumbullon bimë mjekësore: Sherbelë, trumze, dëllinjë e zeze, aguliçe. Ka 1 punëtor me kohë të plotë dhe 4 punëtorë sezonal	Mollë e egër, boronicë, manaferra	Tregu i brendshëm
<b>Tropojë</b>						
15	ÇELA	0682659512 Albert Çela	Tropojë (Sopot)	Grumbullon bimë mjekësore të dyta, sherbele etj. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 6 punëtorë sezonal	Gështenjë, mollë e egër, batonice, dëllinjë e egër	Tregu i brendshëm
16	BERBATI	0686264859 Altin Berbati	Tropoje	Grumbullon të gjitha bimët mjekësore , sherbele, trumze, trëndafili i egër. Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 5 punëtorë sezonal	Gështenjë, mollë e egër, manaferra, boronicë, dëllinjë e egër	Tregu i brendshëm dhe i jashtëm
17	MILUSHI	0686412033 Valter Milushi	Tropoje	Grumbullon te gjitha bimët mjekësore Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 5 punëtorë sezonal	Gështenje, mollë e egër, boronicë, dëllinjë e egër	Tregu i brendshëm
18	ZENELI	0682006768 Altin Zeneli	Tropoje	Grumbullon të gjitha bimët mjekësore Ka 2 punëtorë me kohë të plotë dhe 3 punëtorë sezonal	Gështenjë	Tregu i brendshëm



## 9. SHTOJCA B - BIZNESET NË PJESËN E KOSOVËS

LISTA E BIZNESEVE TË IDENTIFIKUARA NË KOSOVË				
Emri i Biznesit	Vendi	Veprimtaria	Eksportues	Kontaktet
BIOTICA	Bllacë - Suharekë	Përpunim, kultivim, paketim dhe shitje të çajve si: kamomil, xhenxhefil, sherbelë, lule shtog, brusnicë dhe boronicë. Biznesi synon që të zhvillojë veprimtarinë e përpunimit të vajrave etilike. Biznesi ka 2 punëtorë të regjistruar dhe 4 punëtorë sezonal përgjatë muajve Maj-Nëntor.	Biznesi bën shitjen e produkteve në tregun vendor, kryesisht barnatore dhe qendra tjera treguese.	Pronar: Hysni Guraziu Tel: +383 44 537-708 +383 44 945 743 E-mail: biotica@hotmail.com
Hit Flores	Dragash	Është një ndër përpunuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë të produkteve pyjore jo-drusore. Aktualisht, ka kontrata me 150 familje, të cilat përdorin një sipërfaqe prej mbi 37,000 hektarë për të mbledhur produkte të pyjore jo-drusore. Biznesi ka në pronësi 150 hektarë ku kultivohen mjedra dhe dredhëz. Ka gjithsej 20 punëtorë me orar të plotë, përgjatë tërë vitit, ndërsa ka 70-100 punëtorë sezonal. Biznesi bashkëpunon me rreth 4.000 mbledhës nga i gjithë territori i Kosovës.	Eksportues direkt në vendet evropiane (Gjermani)	Pronar: Arafat Berisha <a href="http://hitflores.com">http://hitflores.com</a> hitflores@hotmail.com Tel: +383 44 148 155 +383 44 760 782
NTH 2000	Brezne, Dragash	Grumbullim dhe pastrim të produkteve pyjore jo-drusore në rajonin e Dragashit. Biznesi ka kontrata me 40 familje. Kanë 4 punëtorë sezonal, gjatë muajit Maj-Nëntor të cilët pastrojnë produktet e mbledhura dhe 15 punëtorë të rregullt që mbledhin.	Produktet grumbullohen me destinacion eksporti. Ato shiten në Agroprodukt, Istog.	Pronar: Besarb Krasniqi Tel: +383 45 686 844

Alko-Natura	Kosavë, Dragash	<p>Është biznes i ri me qendër në Sharr (Dragash) e cila merret me grumbullimin, përpunimin dhe marketingun e bimëve dhe frutave BIO.</p> <p>Tani për tani kompania ofron mbi 10 produkte të cilat rriten tërësisht në mënyrë natyrale në bjeshkët e Sharrit.</p> <p>Kanë 2 punëtorë me orar të plotë (familjarë) dhe kanë kontrata bashkëpunimi me 30 familje, që ndryshojnë varësisht prej angazhimit dhe ngarkesës së punës.</p>	Biznesi është eksportues direkt në vendet e BE-se (Gjermani)	<p>Pronar: Ensar Guri</p> <p><a href="http://alko-natura.com">http://alko-natura.com</a></p> <p>info@alko-natura.com</p> <p>+377 44 408 057</p> <p>Adresa: Kosavë, Dragash, Kosovë</p>
Agro Shqiponja	Tërpezë Malishevë	<p>Biznesi bën grumbullimin, përpunimin dhe kultivimin e bimëve aromatike dhe bën prodhimin e fidanëve organike. Nga 2014 biznesi ka filluar me kultivimin e bimëve mjekuese.</p> <p>Biznesi ka të angazhuar 6 punëtorë të rregullt (me kontrata) për tërë vitin. Afërsisht 60 familje përpunojnë produktet në fermat e veta për t'i shitur ato në Agro Shqiponja dhe ato janë nga pjesë të ndryshme të Kosovës.</p>	Produktet grumbullohen me destinacion eksporti. Ato shiten në Agroprodukt, Istog.	<p>Pronar: Shefqet Krasniqi</p> <p>Tel: +377 44 403 715</p>
Natural Frut	Budakovë Suharekë	<p>Bën grumbullimin, përpunimin dhe shitjen e produkteve të bimëve të përpunuara si: kërpudha, dhelparake, manaferra të egra boronicë e egër, kaça të egra, dredhëza të egra, dëllinjë e zezë dhe e kuqe, aguliçe, shtog.</p> <p>Stafi: 10-15 punëtorë sezonal të kërpudhës (gra) në punëtori – pikën grumbulluese, kryesisht familjarë.</p> <p>Biznesi ka 25 pikë grumbulluese në krejt Kosovën, ku janë të angazhuar deri në 500 familje në krejt Kosovën</p>	Produktet grumbullohen me destinacion eksporti. Ato shiten në Agroprodukt, Istog.	<p>Pronar: Hamit Buzhala</p> <p>Tel: +377 44 206 324</p>

Fito Trade SHPK	Shajne - Dragash	<p>Bën grumbullimin, përpunimin dhe shitjen e produkteve të bimëve të përpunuara si: kërpudha dhe parake, manaferra të egra boronicë e egër, kaça të egra, dredhëza të egra, dëllinjë e zezë dhe e kuqe, aguliçe, shtog.</p> <p>Biznesi ka 4 punëtorë të rregullt, 8 sezonal dhe 25 pikë grumbulluese, deri në 500 familje që grumbullojnë produktet.</p>	Produktet grumbullohen me destinacion eksporti. Ato shiten në Agroprodukt, Istog.	<p>Pronar: Elvis Osmani Tel: +386 49 130 572 osmanosman99@yahoo.com</p>
Malësia Herbs	Radoste Rahovec	<p>Malësia Herbs është zhvilluar në kuadër të Tradita Shpk. Biznesi bën grumbullim, kultivim, terje dhe shitje të çajëve dhe bimëve mjekuese.</p> <p>Staf i përhershëm janë 7 persona përgjatë 12 muajve, ndërsa sezonalë janë 7-8, varësisht nga nevoja.</p> <p>Në kuadër të bashkëpunimit me kompaninë Malësia Herbs, 7 fermerë/familje janë pajisur me tharëse, në mënyrë që të grumbullojnë dhe thajnë vet produktet që i mbledhin. Biznesi ka kontrata afatgjata me këto 7 familje.</p>	Produktet grumbullohen me destinacion eksporti. Ato shiten në Agroprodukt, Istog.	<p>Pronar: Armend Kastrati malesiaherbs@gmail.com Tel: +377 44 185 331</p>
Bio Farm "Lorena"	Prizren	<p>Grumbullim, tharje, përpunim dhe paketim (për eksport) të frutave të malit dhe bimëve mjekësore. Biznesi po ashtu bën edhe kultivimin e manaferrave.</p> <p>Bimët mjekësore dhe aromatike si dhe erëzat dhe frutat e thata përdoren kryesisht në industrinë farmaceutike, ushqimore dhe kozmetike.</p> <p>Biznesi funksionon në kuadër të fermës së pulave të po të njëjtit pronar.</p>	Produktet grumbullohen me destinacion eksporti. Ato shiten në Agroprodukt, Istog.	<p>Pronar: Qazim Morina +383 44 833-990 lorenabiofarma@gmail.com</p>

## 10. SHTOJCA C - METODOLOGJIA

### Hulumtimi i tregut në Shqipëri dhe Kosovë në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të frutave të malit dhe bimëve mjekësore

*Në bazë të termave të referencës, ky hulumtim do të jetë i fokusuar në:*

- 1) Identifikimin e ndërmarrjeve, punëdhënësve apo pikave grumbulluese të cilat merren me frutat e malit dhe bimët mjekësore në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë;
- 2) Nevojat e punëdhënësve në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të frutave të malit dhe bimëve mjekësore, për të zvogëluar zbrazëtite mes kërkesës dhe ofertës;
- 3) Potencialin zhvillimor në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të frutave të malit dhe bimëve mjekësore në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë.

*Metodologjia që do të aplikohet në kryerjen e këtij hulumtimi përfshin një sërë teknikash, si në vijim:*

- 1) Rishikim i literaturës (hulumtimeve, raporteve nga tereni, raporteve teknike) dhe të dhënave ekzistuese, specifike për secilin rajon, duke përfshirë potencialet për zhvillimin dhe shtrirjen e veprimtarisë së grumbullimit dhe përpunimit të këtyre produkteve;
- 2) Hartëzimi i bizneseve të rajoneve përkatëse (Mapping) - Takime të drejtpërdrejta me institucionet e bashkive/komunave përkatëse, organizatave jo-qeveritare (OJQ-të), drejtoritë e pyjeve, agjencitë rajonale të mjedisit, qendrave të biznesit dhe grupeve tjera të interesit, të kyçur në projekte të zhvillimit të këtij sektori.
- 3) Vizita në teren, realizimi i intervistave të thella, gjysmë të strukturuar me grumbulluesit dhe përpunuesit e bimëve mjekësore, duke përfshirë bizneset e mëdha dhe pikat më të mëdha grumbulluese të rajoneve përkatëse;
- 4) Përpunimi dhe analizimi i të dhënave;
- 5) Draftimi i raportit mbi të gjeturat;
- 6) Raportimi final (pas konsolidimit të komenteve nga ana e përfaqësuesve të projektit SWEI).

## 11. SHTOJCA D – PYETËSORI

Prezantimi i intervistueses/it

Përshëndetje, unë quhem \_\_\_\_\_ (emri i intervistueses/it) dhe jam e/i angazhuar nga APPK/ISI në kuadër të projektit projekti SWEI. SWEI – “Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik”, projekt i programit ndër-kufitar Shqipëri-Kosovë i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt është dizajnuar me qëllimin që të nxisë bashkëpunimin, shkëmbimin e përvojave, përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së Shërbimeve të Punësimit/Qendrave të Aftësimit Profesional për punësim të qëndrueshëm të punëkërkuesve, trajnimin e të rinjve për të mbështetur integrimin social-ekonomik në rajonin ndër-kufitar Shqipëri-Kosovë.

Ne po kryejmë disa intervista për të identifikuar ndërmarrjet, punëdhënësit dhe pikat grumbulluese të frutave të malit dhe bimëve mjekësore në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë. Qëllimi i këtyre intervistave është jo vetëm të bëhet identifikimi por edhe të identifikohen nevojat e punëdhënësve në këtë fushë, me theks të veçantë – zvogëlimin e zbrazësisë në mes të kërkesës dhe ofertës. Për më shumë, projekti është i interesuar që të mësojë më shumë për potencialin zhvillimor në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të frutave të malit dhe bimëve mjekësore në territorin e brezit kufitar Shqipëri-Kosovë.

Të gjeturat e këtij hulumtimi do të mbështesin qëllimin e projektit. Duhet t’ju shpjegoj se duhet të mbaj shënime të hollësishme mbi emrin tuaj, pozitën në institucion, si dhe detajet e kontaktit tuaj, të cilat do të ndahen me projektin.

### 1. Të dhënat mbi biznesit:

1. Emri i Biznesit:
2. Emri i personit të intervistuar:
3. Pozita e personit të intervistuar në kompani:
4. Numri i telefonit:
5. E-mail adresa:
6. Viti i themelimit:
7. Numri i punonjësve:
- 7.1 Numri i punëtorëve të përhershëm/me orar të plotë;
- 7.2 Numri i punëtorëve të përkohshëm
- 7.3 Numri i punëtorëve e sezonal

**2. A keni pasur rritje/ulje të punëtorëve gjatë këtij viti?**

---

---

**3. Si është ecuria e biznesit viteve të fundit?**

---

---

---

**4. Cilat janë anët e forta/përparësitë e biznesit tuaj në krahasim me bizneset tjera të kësaj fushe?**

---

---

---

**5. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqoheni si biznes?**

*(Lexo: Për shembull: Nuk ka kërkesë në treg për produktet tona, çmimi është zvogëluar për shkak të konkurrencës së madhe, importimi i produkteve të lira në tregjet vendore, barriera doganore (nëse ka, cilat janë ato?), etj.)*

---

---

---

**6. Në cilat vështirësi ka hasur biznesi juaj (menaxhimi i biznesit)?**

*(Lexo: Për shembull, vështirësi në rekrutim të stafit, stafi ka nevojë për trajnim shtesë për të punuar në këtë sektor, vështirësi në planifikim dhe marketing të biznesit)*

---

---

---

**7. Cilat janë vështirësitë e juaja në grumbullim, mirëmbajtje dhe përpunim të produkteve?**

*(Lexo: Për shembull, mungesë të fuqisë punëtore në grumbullim të produkteve, mungesë të pajisjeve që bëjnë mirëmbajtjen e produkteve dhe përpunimin e tyre, problem me energjinë elektrike, etj.)*

---

---

---

---

---

**8. Cilat janë pikët e forta apo edhe lehtësirat për zhvillimin e këtij biznesi?**

(Lexo: Për shembull, kushtet e qëndrueshme politike dhe sociale, potenciali që kjo fushë e biznesit të rritet ende më shumë në të ardhmen, fuqi punëtore – popullatë vendore që është e interesuar të punojë me këto produkte etj.)

---

---

---

**9. A mendoni se ka potencial që biznesi me fruta të malit dhe bimë mjekësore të rritet në të ardhmen?**

---

---

---

**10. Me sa familje (grumbullues të produkteve) bashkëpunoni gjatë vitit? Sa mendoni se mund të fitojë një familje (përgjatë vitit) nëse merret me grumbullim të këtyre produkteve dhe shitje të tyre në pikat grumbulluese?**

---

---

---

**11. Cilat janë nevojat kryesore në biznesin tuaj?**

(Lexo: trajnim të punëtorëve (nëse po, cilat), shtim të pajisjeve për grumbullim/ruajtje/përpunim të produkteve etj.)

---

---

---